

MIMOZA PRIKU LEZE CACAJ

SHTËPIZA E PARË E SHKRONJAVE

Për klasën e parë të shkollës fillore

LIBRI I MËSUESIT/ES

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2025

Dr. Mimoza Priku Mr. Leze Cacaj
SHTËPIZA E PARË E SHKRONJAVE
për klasën e parë të shkollës fillore
GJUHA SHQIPE 1
Libri i mësuesit

PRVA KUĆICA SLOVA
za prvi razred osnovne škole
ALBANSKI JEZIK 1
PRIRUČNIK

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Për botuesin: Mr. Aleksandra Hajduković, drejtoreshë

Kryeredaktor: Mr. Radulle Novović

Redaktor përgjegjës: Llazo Leković

Redaktor: Dimitrov Popović

Recensentë: Dr. Artan Haxhi
Mr. Maja Goçaj
Mr. Anton Goçaj
Dr. Fatmir Vadahi
Mr. Ardita Kovačević

Lektor: Sidorela Berishaj

Korrektor: Mr. Marjan Lulçuraj

Dizajni dhe faqesja: Momçillo Qorović

Ilustrimet: Edin Kapllani

Redaktore teknike: Dajana Vukčević

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2568-7
COBISS.CG-ID 36391940

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 08/2-119/25-7446-3,
datë 16.07.2025 e ka miratuar këtë Libër të Mësuesit për përdorim në shkollat
fillore.

Copyright c Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2025

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje.....	5
------------	---

Kap. I Flasim.....	
--------------------	---

Mësimi 1. Përhëndesim: Mirëmëngjesi! Mirëdita! Tungjatjeta!.....	9
Mësimi 2. Një mëngjes i veçantë.....	11
Mësimi 3. Përhëndesim: Mirupafshim! Ditën e mirë! Mirëmbërma! Natën e mirë!.....	13
Mësimi 4. Familja ime dhe përshëndetjet.....	15
Mësimi 5. Falënderojmë.	17
Mësimi 6. Si t'u drejtohem të rriturve.....	19
Mësimi 7. Kërkojmë falje.....	21
Mësimi 8. Fjalët magjike.....	24
Mësimi 9. Si të urojmë.....	26

Kap. II Dëgjojmë dhe dallojmë tingujt e shkronjat.....	
--	---

Mësimi 10. Dallojmë tingujt e artikuluar.....	29
Mësimi 11, 12. Shporta e tingujve dhe e shkronjave. Përsëritje. (2 orë).....	31
Mësimi 13. Tinguj të njëjtë – rima.....	33
Mësimi 14. Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj të ndryshëm.....	35
Mësimi 15, 16 Përsëritje. Tinguj të njëjtë. Tinguj të ndryshëm (2 orë).....	37
Mësimi 17. Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në fillim të fjalës 1.....	39
Mësimi 18. Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në fillim të fjalës 2	41
Mësimi 19. Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në mes të fjalës 1.....	43
Mësim 20. Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në mes të fjalës 2	45
Mësimi 21. Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në fund të fjalës 1	47
Mësim 22. Përsëritje. Tinguj në fund të fjalës 2	49
Mësim 23, 24. Përsëritje. Tinguj në fillim, në mes dhe në fund të fjalës (2 orë)	51
Mësim 25, 26. Tinguj të përafërt dhe shkronja të ngjashme. Përsëritje. (2 ose 3 orë)	54
Mësimi 27, 28. Vendi dhe renditja e tingujve - shkronjave në fjalë. Përsëritje (2 orë)	56

Kap. III “Lexojmë”.....	
-------------------------	---

Mësimi 29. Njohim fjalën si tërësi të foluri. Krijojmë fjali mbi bazën e figurave 1	58
Mësimi 30. Njohim fjalën si tërësi të foluri. Krijojmë fjali mbi bazën e figurave 2	60
Mësimi 31. “Lexojmë” së bashku 1.....	62
Mësimi 32. “Lexojmë” së bashku 2	64
Mësimi 33. Krijojmë tekste sipas figurave. Përsëritje. (2 orë).....	66
Mësimi 34, 35 Krijojmë tekste figurative. Pasionet e mia (2 orë).....	68

Kap. IV “Shkruajmë”.....	
--------------------------	---

Mësimi 36, 37 Elementet e shkronjave. Përsëritje (2 orë).....	70
Mësimi 38. Formojmë shkronja.....	72
Mësimi 39, 40. Provojmë të shkruajmë. Përsëritje (2 orë).....	74
Mësimi 41. Unë shkruaj.....	76
Mësimi 42, 43 Dallojmë shkronjat e njëjta dhe të ndryshme në fjalët e shkruara.....	77



Kreu V Dëgjojmë dhe komunikojmë.....

Mësimi 44, 45 Ruajmë natyrën. Përsëritje (2 orë).....	79
Mësimi 46, 47 Pranvera, Përsëritje (2 orë).....	81
Mësimi 48, 49 Kujdesi për dhëmbët. Përsëritje (2 orë)	83
Mësimi 50. Telefoni	85
Tekstet	87
Burime dhe literatura.....	90

Hyrje

Përvetësimi i gjuhës nga fëmijët është një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm, që nis që me lindjen e tij, me marrjen gjuhësore, së pari me ndihmën e prindit, vazhdon me edukimin parashkollor e vjen gradualisht në stadin më të rëndësishëm, atë shkollor. Ky aftësim gjuhësor kërkon kohë, përkujdesje e përkushtim. Ky përvetësim priret të kundrohet sot më shumë si një proces se sa një produkt, me një qasje psikolinguistike¹.

Pikërisht për t'i ardhur në ndihmë këtij procesi, kemi propozuar modelin tonë të marrjes dhe të përvetësimit të gjuhës shqipe që ne e kemi titulluar "Shtëpiza e parë e shkronjave".

Teksti "Shtëpiza e parë e shkronjave" është hartuar në bazë të programit të "Gjuhës shqipe dhe Letërsisë", të miratuar nga organet përkatëse në Mal i Zi (Podgoricë, 2017). Klasa e parë ka si qëllim të parë aftësimin e nxënësve për komunikim dhe e fton nxënësin që ky komunikim të bëhet hap pas hapi në gjuhën shqipe standarde. Për ta realizuar këtë qëllim, nxënësi duhet të përballë të njohë disa prej strategjive kryesore të komunikimit, fillimisht mëson se si të hyjë në komunikim me të tjerët, qofshin anëtarë të familjes e pastaj edhe në anëtarë të ndryshëm në shoqëri (mësuesen, shokët, të rriturit etj.).

Në realizimin e këtij teksti është marrë në konsideratë që aftësimi i nxënësve për gjuhën, e më pas krijimi i shprehive dhe i shkathtësive, të realizohet përmes katër komponentëve: të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit.

Ky tekst është hartuar në mbështetje të realizimit të funksionit kryesor të gjuhës, funksionit komunikativ i cili do të realizohet hap pas hapi përgjatë gjithë tekstit. Ky funksion nuk mund të realizohet pa kodin e përbashkët, gjuhën, prandaj nëpërmjet figurave, bisedave, lojërave të ndryshme që propozohen të realizohen me nxënësit, nxënëset, me ndihmën e mësuesit, nga kodi i vendlindjes afrohen dalëngadalë me shqipen standarde.

Teksti i nxënësit është i ndërtuar në pesë kapituj: "Flasim", "Dëgjojmë dhe dallojmë tingujt e shkronjat", "Lexojmë", "Shkruajmë" dhe "Dëgjojmë dhe komunikojmë".

Brenda kapitullit të parë, "Flasim", nxënësit mësojnë nëpërmjet situatave të ndryshme të përdorin përshëndetjet e ndryshme, si "Mirëmëngjes!", "Mirëdita!", "Tungjatjeta", "Mirupafshim!", "Ditën e mirë!", "Mirëmbërë!", "Natën e mirë!" etj. Nxënësit aftësohen për të përdorur "fjalët magjike", si "Më fal", "Të lutem", "Faleminderit!" etj. Pjesë integrale e këtij libri do të jenë tekste të ndryshme ilustruese të cilat janë përfshirë brenda "Librit të mësuesit" dhe në tekstin e nxënësit jepen me një simbolikë orientuese. Janë krijuar tekste, si "Një mëngjes i veçantë", "Familja ime dhe përshëndetjet" në mënyrë që nxënësi t'i rrokë elementet e përmendura më lart brenda tërësisë së një teksti e jo vetëm të segmentuara. U lihet hapësirë fëmijëve që të komunikojnë lirshëm me mësimdhënësin dhe nxënësit e tjerë, të ndërveprojnë me njëritjetrin duke u dhënë mundësi ta përdorin sa më shumë gjuhën dhe të zhvillojnë të folurit. Edhe sipas didaktëve të gjuhës shqipe "Ushtrimet e të folurit ndihmojnë në procesin e përgjithësimin të përvojës, në përgjithësimin e metodave dhe të mënyrave të të menduarit e të kuptuarit të një situatë të caktuar. Për të ndihmuar këtë proces duhen përpunuar dhe zgjedhur ato forma ushtrimesh të specializuara, që e lehtësojnë këtë proces. Prej koncepteve

1 Shih: Eve V. Clark. *First Language Acquisition*. Cambridge University Press; 2009, f. 10.

të caktuara dhe të veçuara duhet të ndërtohet dhe të përgjithësohet koncepti kryesor, i cili përfaqëson cilësitë e përgjithshme, thelbësore dhe të domosdoshme të një lloji të caktuar objekteve. Për këtë, luan rol të veçantë zhvillimi i kujtesës dhe abstragimi”²

Nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme u lihet krijimtari nxënësve për të ndërtuar situata, për ta paraqitur mendimin e tyre përmes vizatimeve, lojërave, muzikës etj. Për të realizuar këtë strategji është bërë i mundur integrimi apo korrelacioni i tekstit me edukimin muzikor (gati çdo mësim propozohet që të shoqërohet me një këngë), edukimin figurativ (nxënësve u kërkohet që të vizatojnë, të ngjyrosin, të krijojnë kartolina etj.). Por në kapitujt në vijim korrelacioni është bërë i mundur edhe me disiplina pak të largëta, si matematika. Fëmijëve u kërkohet të bashkojnë numrat për të krijuar figura të ndryshme, të numërojnë sasinë e tingujve në një fjalë etj.

Kapitulli i dytë **“Dëgjim dhe dallojmë tingujt e shkronjat”** është mjaft i rëndësishëm sepse e përfshin fëmijën dalëngadalë në botën e tingujve e më tej të shkronjave. Nxënësi duhet të arrijë që të dallojë tingujt e artikuluar nëpërmjet aparatit artikullativ [a], [b]. Nxënësit prezantohen me shkronjat e alfabetit në mënyrë globale. Në tema, si “Shporta e tingujve dhe e shkronjave” nxënësit njihen me tingujt e shqipes standarde nëpërmjet objekteve të ilustruara dhe të shqiptuara nga mësuesi. Ata ushtrohen që t’i shkruajnë për herë të parë shkronjat, vetëm shkronjat kapitale dhe duke ndjekur pikat, në mënyrë që nxënësi të fillojë të lidhë dalëngadalë konceptin tingull-shkronjë. Një element mjaft i rëndësishëm është ushtrimi i fëmijëve me tingujt që përputhen apo rimën. Në këtë mënyrë nxënësit jo vetëm i përvetësojnë tingujt, por edhe mësohen që t’i përdorin tingujt e njëjtë, duke zgjeruar e pasuruar në këtë mënyrë edhe fjalorin e tyre. Roli i punës me rimën është parë edhe nga studiuesit si mjaft i rëndësishëm. Për këtë arsye në tekst janë vendosur ushtrime që fëmija mund t’i punojë në klasë me mësuesin/en, por edhe prindi mund të luajë rol, sepse “Duke marrë parasysh rëndësinë e zhvillimit të aftësive për rimimin si parakusht për një lexim të suksesshëm, rekomandimet shkojnë për një bashkëpunim midis prindërve në shtëpi, si edukatorë të gjuhës së parë të fëmijës dhe mësuesit/es në klasë”³.

Krahasimi është përdorur si metodë, sidomos te tingujt, në mënyrë që nxënësi/ja të aftësohet për të bërë dallimin e tingujve të njëjtë e atyre të ndryshëm. Vëmendje u është kushtuar tingujve të përbërë që paraqesin një vështirësi të madhe për nxënësit/et. Pikërisht ushtrimet ku tregohet e numërohen tingujt, krahasimet me tingujt të tjerë do të bëjnë që fëmijët të dallojnë një tingull [h] nga [θ] nga shkronja T e TH e kështu me radhë.

Pozicioni i tingullit në fillim, në mes dhe në fund jemi munduar që t’i paraqesim këto dallime me llojshmëri ushtrimesh për të mos e mërzitur fëmijën, por t’i vijnë këto koncepte nëpërmjet lojërave të ndryshme. Duke luajtur me tingujt ai i përvetëson më mirë.

2 M. Gjakutaj & E. Dode, *Didaktika e gjuhës shqipe* (kurrikula I-VI), Shtëpia Botuese “Shkronjë pas Shkronje”, Tiranë, 2013, f. 145.

3 M. Priku & J. Bushati & A. Sula & L. Kashahu “One approach for the role of rhyming dictionaries in developing children's language proficiency and the multimedia technologies” [Një qasje për rolin e fjalorëve rimorë në zhvillimin e aftësive gjuhësore të fëmijëve dhe teknologjive multimediale], në *European Scientific Journal*, May 2014 edition vol.10, f. 27.

Është marrë në konsideratë tërheqja e fëmijëve ndaj teknologjisë, prandaj janë vënë objekte që i nxisin ato për t'i identifikuar objektet që i njeh ose edhe për të njohur të reja.

Rendi i tingujve është një element fjalë krijues e kuptimdallues, prandaj nxënësi duhet të kuptojë rëndësinë që ka rendi i tingujve a i shkronjave në një fjalë. Me interes për përvetësimin e tingujve dhe dalëngadalë të shkronjave janë edhe tema që lidhen me tinguj që afrojnë në shqiptim dhe janë të ngjashëm në shkrimin e tyre, prandaj këtu nuk është marrë në konsideratë rendi i tingujve a shkronjave sipas alfabetit, por sipas ngjashmërive të tyre fonologjike dhe grafike. Ushtrimet e dhëna në formën e lojës i afrojnë ato me personazhet e filmave vizatimorë, në mënyrë që ta memorizojnë shkronjën edhe vendin e saj përmes personazheve. Evokohen nxënësit me personazhe të tillë, si Pokemon, Goku, Nemo etj.

Në Kapitullin III **“Lexojmë”** nxënësi njihet me konceptin e fjalës si tërësi fonologjike. Nëpërmjet lidhjes së figurës së pemës nxënësi shkon tek fjala. Loja me rrokje, loja e fjalëkryqit janë dhënë për ta ndihmuar këtë proces. Nxënësit arrijnë “të lexojnë” përmes figurave, të krijojnë histori.

Kapitulli IV **“Shkruajmë”** e afron nxënësin me procesin e të shkruarit. Ai duhet të ushtrojë dorën për të shkruar. Për ta realizuar këtë qëllim janë dhënë elementet e para të shkronjave me anë të vijave të lakuara e të harkuara në mënyra të ndryshme e sa më zbavitëse për ta. Në formën e lojës vjen edhe krijimi i shkronjave me materiale të ndryshme, si plastelinë, produkteve ushqimore (makarona, oriz etj.). Sërish nëpërmjet fjalëve të shkruara me pika dhe në përshtatje me figurën përkatëse, nxënësit ushtrohen për ta shkruar fjalën e plotë duke ndjekur gjurmët, gjithmonë vetëm me shkronjat e mëdha. Nxënësi përballet me sfidat e para për të shkruar emrin e vet me ndihmën e mësuesit e prindit. Edhe lojërat zbavitëse për të krijuar kafshët me anë të bashkimit të pikave ushtrojnë dorën në mënyrë që nxënësi të fillojë të krijojë lirshmëri në përdorimin e lapsit.

Secila prej temave të kapitulli të pestë **“Dëgjojmë dhe komunikojmë”** e fton nxënësin/en të ndërveprojë me anë të komunikimit e të diskutojë, të analizojë tekste të shkurtra joletrare, si **“Ruajmë natyrën”**, **“Pranvera”**, **“Kujdesi për dhëmbët”**, **“Telefoni”**. **“Ndërgjegjësimi për vlerën e tregimeve është thelbësor për këdo që punon ose jeton me fëmijë. Fëmijët kanë nevojë për gjëra që i ndihmojnë të kuptojnë çfarë po ndodh në jetën e tyre: gjërat themelore si lumturia dhe trishtimi, vështirësi në lidhje me prindërit dhe mësuesit, vëllezërit e motrat dhe miqtë. Fëmijët gjithashtu kanë nevojë për gjëra që i angazhojnë, i bëjnë të qeshin, u zgjojnë imagjinatën e tyre. Të gjitha këto mund të fitohen nga tregimet”⁴.**

Mësuesit/et do të gjejnë shumë propozime se si të organizojnë orën e mësimit për secilën prej temave. Prezantohen metoda e teknika të ndryshme që bazohen si në punën e përbashkët, ashtu edhe atë individuale; metoda në formën e lojës, biseda (që zhvillon shumë komunikimin). Në etapën e Evokimit, por edhe atë të Reflektimit janë propozuar këngë që lidhen me njësinë mësimore. Për çdo këngë apo film që sugjerohet është vendosur edhe linku përkatës ku mësuesit mund të konsultohen.

Propozohen të përdoren mjete përveç tekstit të nxënësit, lapsave me ngjyra, tabelës, shkurtesave me ngjyra edhe mjete digjitale, si kompjuter, video-projektor, CD etj.

4 Mary Medlicott, *Storytelling and story-reading in early years: How to tell and read stories to young children*. Jessica Kingsley Publishers: London and Philadelphia, 2018.

Përdorimi i teknologjisë gjatë mësimdhënies është kthyer në një domosdoshmëri. “Kohët e fundit është rritur gjithnjë e më shumë vëmendja për një mësimdhënie cilësore dhe bashkëkohore. Janë zhvilluar strategji të reja të cilat e kanë të domosdoshme përdorimin e metodave të reja. Këto dukuri nisën fillimisht në vendet e zhvilluara dhe kjo përvojë po ndiqet gjithnjë e më shumë nga vendet e tjera. Një nga këto strategji ka të bëjë me mundësinë e përfshirjes më të gjerë të informacionit dhe komunikimit.”⁵

Simbolet do ta ndihmojnë nxënësin që të orientohet në tekst.



Flas



Vizato



Dëgjo



Muzikë



Ngjyros me ngjyrë të verdhë



Shkruaj



Rretho



Krahaso



Shqipto



Film



Lexo



Libri i mësuesit.

5 Jozef Bushati, Gëzim Dibra, Mimoza Priku, “Problematic of learning for reading and writing in pre-school and first grade of pre-university education, through multimedia”, *Education for the knowledge society*, 1st Albania International Conference on Education (AICE), Tirana, 7-8 december, Proceeding pg. 102-114.



I. FLASIM

MËSIMI 1

PËRSHËNDESIM: MIRËMËNGJESI! MIRËDITA! TUNGJATJETA!

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Përshtendesi: Mirëmëngjesi! Mirëdita! Tungjatjeta!

Arritjet e të nxëniti:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

* të zbatojë rregullat e mirësjelljes dhe të përdorë shprehjet përkatëse:

- kur dhe si të përshëndesë dikë.

Tipi i orës: orë për përvetësim / përforsim të njohurive

Metodat dhe teknikat: tryeza e rrumbullakët, brainstorming, bisedë, lojë me role (dramatizim).

Format e punës: punë frontale, në grup.

Aktivitetet e nxënësve:

- komentojnë dyfletëshin
- identifikojnë fjalët përshëndetëse;
- komentojnë dhe diskutojnë me shokët situatat e paraqitura në tekstin mësimor;
- shprehin lirshëm dhe saktë mendimin e tyre;
- dramatizojnë lojë në role.

Korrelacioni: art figurativ, natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore.


Mjetet: teksti mësimor, tabelë, shkumës, fotografi me situata të ndryshme, projektor, kompjuter etj.

Fjalë kyçe: Mirëmëngjesi! Mirëdita! Tungjatjeta!

Evokim

Hapi I - Veprimtari paraprake

*Nxënësit e vendosur në formë rrethi tregojnë nga një fjalë, që mendojnë se është një përshëndetje. Mësuesja shkruan në tabelë ato fjalë, që janë përshëndetje dhe nxit nxënësit të përgjigjen në pyetjet: *Kur i përdorim këto fjalë? Ku i përdorim?*



*Nxënësit dëgjojnë dhe këndojnë këngën për fëmijë “Mirëmëngjesi”.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues - i/ja shkruan në tabelë titullin e mësimit “ **Mirëmëngjesi! Mirëdita! Tungjatjeta!**”

*Nxënësit/et për disa minuta vëzhgojnë ilustrimet në faqen 3 dhe diskutojnë me njëri-tjetrin.

Më pas komentojnë situatat, kur dhe ku duhet të përdorim shprehjen: **Mirëmëngjesi!**

Situata 1 - Fëmija zgjohet nga gjumi.

Situata 2 - Fëmija përshëndet familjarët në kuzhinë - MIRËMËNGJESI FAMILJA!

Situata 3 - Fëmija përshëndet gjyshen - MIRËMËNGJESI GJYSH E GJYSHE!

Situata 4 - Nxënësit përshëndesin mësuesen - MIRËMËNGJESI MËSUESE!

Nxënësit tregojnë situata të tjera ku përdorin shprehjen Mirëmëngjesi!

*Nxënësit vëzhgojnë ilustrimet dhe komentojnë situatat, kur dhe ku përdorin shprehjen:

Mirëdita!

Situata 1 - Fëmijët përshëndesin nënën dhe babain në oborr.

Situata 2 - Nëna dhe djali përshëndesin mjeken.

Situata 3 - Vajza përshëndet djalin që po shetit qenin.

Situata 4 - Nxënësi përshëndet bibliotekaren.

Nxënësit tregojnë situata të tjera ku përdorin shprehjen: Mirëdita!

*Nxënësit/et së bashku me mësues-in/en komentojnë situatat, kur dhe ku përdorin shprehjen: **Tungjatjeta!**

Situata 1 – Fëmijët përshëndesin njëri-tjetrin.

Situata 2 – Gjyshërit përshëndesin nga celulari.

Situata 3 – Vajza përshëndet shokët në park.

Nxënësit tregojnë situata të tjera ku përdorin shprehjen: Tungjatjeta!

Reflektim

Hapi III – Dramatizim (punë në grupe)

Nxënësit në grupe improvizojnë para klasës situata të ndryshme të përzgjedhura nga ata vetë ose të ndihmuar nga mësues-i/ja. Paraqitja e situatave mund të bëhet edhe përmes videoprojektorit.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për përdorimin e drejtë të fjalëve përshëndetëse gjatë lojës me role (dramatizimit).

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____



MËSIMI 2

NJË MËNGJES I VEÇANTË

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Një mëngjes i veçantë

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zbatojë rregullat e mirësjelljes dhe të përdorë shprehjet përkatëse;
- kur dhe si të përshëndesë dikë.

Tipi i orës: orë për përforsim njohurish

Metodat dhe teknikat: bisedë, lexim i drejtuar, marrëdhëniet pyetje-përgjigje, lapsat në mes, turi i galerisë.

Format e punës: punë frontale, individuale

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë fjalët përshëndetëse;
- diskutojnë me shokët për ditën e parë të shkollës;
- dëgjojnë me vëmendje tekstin dhe komentojnë atë;
- komunikojnë lirshëm dhe saktë mendimin e tyre;
- vizatojnë ditën e parë në shkollë.

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ

Mjetet: teksti mësimor, tabelë, shkumës, fotografi, laps, gomë, ngjyra etj.

Fjalë kyçe: përshëndetjet, shkollë, nxënës, urim.

Evokim

Hapi I - Veprimtari paraprake

- Nxënësit tregojnë përshëndetjet e mësuara në mësimin e parë.

Hapi II

- Nxënësit marrin pjesë aktive në bisedën për ditën e parë të shkollës, duke u përgjigjur me përgjigje të plota për pyetjet e mësues-it/es:
- Si ishte dita e parë e shkollës për ju?
- Si u përgatitët për ditën e parë të shkollës?
- Kush ju ndihmoi?
- Si ju përshëndetën prindërit? Si ju uruan për ditën e parë të shkollës?
- Si ishte shkolla? Si ju priti mësuesja dhe edukatorja?
- Si e përshëndetët mësuesen, edukatoren dhe shokët/shoqet?
- A gjetët shokë apo shoqe që i njihnit më parë?

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimit **“Një mëngjes i veçantë”**.

*Nxënësit për disa minuta vëzhgojnë ilustrimet në faqen 11 dhe diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit **“ Një mëngjes i veçantë”** dhe e komentojnë atë.

Një mëngjes i veçantë

Fjala “Mirëmëngjesi!” është një përshëndetje që e përdorim gjatë mëngjesit për tu përshëndetur me një person. Me këtë përshëndetje shprehim dëshirën për të filluar një bisedë me dikë tjetër. Përshëndetjen “Mirëmëngjesi!” në ditën e parë të shkollës dhe takimin me mësuesen do ta mbani mend gjatë.

Tregohet kujdes që gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehen saktë dhe me fjali të plota.

Reflektim

Hapi IV - Lapsat në mes

Nxiten nxënësit të bëjnë një koment të shkurtër në pyetjen:

Si mendoni, pse fëmijët kanë emocione në ditën e parë të shkollës?

Secili nxënës, pasi komenton pyetjen, lë lapsin në mes të tavolinës dhe dëgjon nxënësit e tjerë.

Hapi V – Truri i galerisë

Detyre - Vizato ditën e parë në shkollë. Plotëso labirintin.

Vlerësim: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Në fund punimet i vendosin në një kënd të klasës dhe vëzhgojnë punën e njëri-tjetrit.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____



MËSIMI 3

PËRSHËNDESIM: "MIRUPAFSHIM! DITËN E MIRË! MIRËMBRËMA! NATËN E MIRË!"

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Përhëndesim: Mirupafshim! Ditën e mirë! Mirëmbërma! Natën e mirë!

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë i aftë të:

- të zbatojë rregullat e mirësjelljes dhe të përdorë shprehjet përkatëse: kur dhe si të përshëndesë dikë.

Tipi i orës: orë për përvetësim dhe përforcim të njohurive.

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim, lojë me role (dramatizim)

Format e punës: punë frontale, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë fjalët përshëndetëse;
- komentojnë dhe diskutojnë me shokët situatat e paraqitura në tekstin mësimor;
- shprehin lirshëm dhe saktë mendimin e tyre;
- dramatizojnë lojë në role.

Korrelacioni: Kultura e artit figurativ, natyrë dhe shoqëri.

Mjetet: teksti mësimor, tabelë, shumës, fotografi me situata të ndryshme, kompjuter, videoprojektor etj.

Fjalë kyçe: Mirupafshim! Ditën e mirë! Mirëmbërma! Natën e mirë!

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit vëzhgojnë ilustrimet e paraqitura me videoprojektor dhe komentojnë ato.

Si i përshëndetni prindërit në mëngjes?

Kur themi "Mirëmëngjesi!"?

Si e përshëndetni mësuesen kur vini në shkollë në mesditë?

Kur themi "Mirëdita!"?

*Si i përshëndetni shokët në kopshtin zoologjik? Kur themi "Tungjatjeta!"?

Tregohet kujdes që gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehin saktë dhe me fjali të plota.

- **Po kur ndahemi si përshëndesim?** Nxënësit të lirë shprehin mendimet e tyre. Diskutohen mendimet e dhëna nga nxënësit.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

- Mësuesi/ja shkruan në tabelë titullin e mësimi: **Përhëndesim: "Mirupafshim!; "Ditën e mirë!; "Mirëmbërma!; "Natën e mirë!"**

- *Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë ilustrimet në faqen 12 dhe të diskutojnë me njëri - tjetrin. Më pas së bashku me mësuesin/en komentojnë situatat, kur dhe ku duhet të përdorin shprehjen: **Mirupafshim! Ditën e mirë!**
- Situata 1 - Babai shkon në punë dhe mami me djalë e përshëndesin.
- Situata 2 – Mami shoqëron fëmijën në shkollë dhe e përshëndet.
- Situata 3 - Mësuesja pas mbarimit të mësimit përshëndet fëmijët.
- Situata 4 – Djali përcjell të afërmit në aeroport dhe i përshëndet.
- **Nxënësit tregojnë situata të tjera, ku përdorin shprehjet: Mirupafshim! Ditën e mirë!**

Hapi III

- Nxënësit komentojnë situatat, kur dhe ku përdorin shprehjen: **Mirëmbërma!**
- Situata 1 – Djali në kinema përshëndet “Mirëmbërma!”
- Situata 2 - Vajzat e baletit përshëndesin publikun “Mirëmbërma!”
- Situata 3 - Djali përshëndet shokun e futbollit “Mirëmbërma!”
- Situata 4 – Gjyshi përshëndet familjen “Mirëmbërma!”
- **Nxënësit tregojnë situata të tjera, ku përdorin shprehjen: Mirëmbërma!**

Hapi III

- Nxënësit komentojnë situatat kur dhe ku përdorin shprehjen: **Natën e mirë!**
- Situata 1 - Gjyshja u lexon nipave para se t’u urojë “Natën e mirë!”
- Situata 2 - Mami uron fëmijën “Natën e mirë!”
- Situata 3 – Përcjellja e miqve me urimin “Natën e mirë!”
- Situata 4 – Në kamping djali uron shokët “Natën e mirë!”
- **Nxënësit tregojnë situata të tjera ku përdorin shprehjen “Natën e mirë”!**

Reflektim

- Nxënësit në grupe improvizojnë para klasës situata të ndryshme të përzgjedhura nga ata vetë ose të ndihmuar nga mësues-i/ja. Paraqitja e situatave mund të bëhet edhe përmes videoprojektorit.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për përdorimin e drejtë të fjalëve përshëndetëse gjatë lojës në role.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____



MËSIMI 4

FAMILJA IME DHE PËRSHËNDETJET

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi : Familja ime dhe përshëndetjet

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë i aftë të:

- të zbatojë rregullat e mirësjelljes dhe të përdorë shprehjet përkatëse;
- kur dhe si të përshëndesë dikë.

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, lexim dhe dëgjim i drejtuar, truri i galerisë

Format e punës: frontale, individuale

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë fjalët përshëndetëse;
- dëgjojnë me vëmendje tekstin dhe komentojnë atë;
- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- vizatojnë dhe prezantojnë familjen e tyre.

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ

Fjalë kyçe: unë, familja, përshëndetjet

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, laps, gomë, ngjyra etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit marrin pjesë në mënyrë aktive në bisedë, duke u përgjigjur me përgjigje të plota për pyetjet e mësues-it/es: Si quhen? Sa vjeç janë? Sa anëtarë ka familja e tyre? A përdorni përshëndetje në familje? Pse ka rëndësi të përdorim përshëndetjet? etj.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi **“Familja ime dhe përshëndetjet”**.

- Nxënësit për disa minuta vëzhgojnë ilustrimin në faqen 15 dhe diskutojnë me njëri – tjetrin. Më pas dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit **“Familja ime dhe përshëndetjet”** dhe e komentojnë atë.

A duhet të përdoren përshëndetjet në familje? Patjetër, edhe brenda familjes duhet të jemi të kujdesshëm dhe t'i përdorim përshëndetjet. Sapo të zgjohemi, përshëndesim me fjalën “Mirëmëngjesi!” gjyshërit, prindërit, si dhe motrat a vëllezërit. Kur largohemi për në shkollë përshëndesim “Ditën e mirë” dhe në darkë “Mirëmbërëma!” apo “Natën e mirë!”. Këto rregulla i mësojmë në fillim në familje e pastaj edhe në shkollë. Ato janë pjesë e domosdoshme e komunikimit në shoqëri.

Tregohet kujdes që gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehen saktë dhe me fjali të plota.

Hapi III

Nxënësit punojnë detyrën e dhënë në tekstin mësimor. Vizatojnë familjen e tyre.

Reflektim

Hapi IV

Nxënësit me radhë dalin para klasës dhe prezantojnë veten dhe familjen duke u ndihmuar nga vizatimi që kanë bërë në libër. Tregojnë përshëndetjen që kanë përdorur në situatën e paraqitur me vizatim.

Nxënësit e tjerë mund t'u drejtojnë pyetje shokëve/shoqeve, nëse duan të dinë diçka më tepër për ta ose familjen e tyre.

Vlerësim: Nxënësit/et vlerësohen për përdorimin e drejtë të fjalëve përshëndetëse gjatë lojës në role.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim _____



MËSIMI 5

FALËNDEROJMË

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimit: Falënderojmë

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zbatojë rregullat e mirësjelljes dhe të përdorë shprehjet përkatëse;
- kur, si dhe kë të falënderojë për diçka

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: lojë, bisedë, diskutim

Format e punës: punë individuale, frontale, në çift, në grup

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë fjalët magjike: Urdhëro! Faleminderit!;
- komentojnë dhe diskutojnë me shokët situatat e paraqitura në tekstin mësimor;
- komunikojnë lirshëm dhe saktë mendimin e tyre;
- improvizojnë situata duke marrë pjesë në lojërat për ushtrimin e komunikimit;
- vlerësojnë në mënyrë kritike sjelljet e personave në ilustrime nga përvoja vetjake.

Korrelacioni: Kultura e artit figurativ

Fjalë kyçe: Urdhëro! Faleminderit!

Mjetet: teksti mësimor, foto të ndryshme, kompjuter, videoprojektor etj.

Evokim

Hapi I - Veprimtari paraprake

Ora fillon me lojë. Mësues-i/ja i jep një nxënësi vullnetar një pako me biskota, që t'ua ndajë shokëve/shoqeve. Nxënësi X, kur u jep biskotat shokëve/shoqeve, shqipton shprehjen **“Urdhëroni”**. Shokët/shoqet e falënderojnë duke përdorur shprehjen **“Faleminderit”**.

Mund të luhet edhe lojë në çifte, ku nxënësit do të improvizojnë situatat me personazhe: gjyshja dhe nipat, mësuesi dhe nxënësi, blerësi dhe shitësi etj. dhe ku do të përdorin shprehjet: **Urdhëro! Faleminderit!** duke u mbështetur në edukimin familjar dhe atë parashkollor.

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësuesja shkruan në tabelë titullin e mësimit **“Falënderojmë”**.

- Nxënësit për disa minuta vëzhgojnë ilustrimet në faqen 16 dhe diskutojnë me njëri – tjetrin. Më pas përgjigjen në pyetjet që u drejton mësues-i/ja për situatat e paraqitura.
- **Situata 1 - Djali i jep vajzës lodrën dhe i thotë: Urdhëro! Vajza falënderon djalin për lodrën dhe i thotë: “Faleminderit!”**
- Pyetjet që mësues-i/ja mund t'ua drejtojë nxënësve: Kë shikoni në fotografi? Çfarë po

bëjnë fëmijët? Si ju duken fëmijët? Çfarë mendoni se i tha djali vajzës kur i dha lodrën? Si e falënderoi ajo? A ju pëlqen sjellja e fëmijëve? Po ju, si do te kishit vepruar? Çfarë mësojmë nga kjo situatë? etj.

– **Situata 2 – Shojja ndihmon shokun në mësim dhe ai i thotë “Faleminderit!”.**

– Pyetjet që mësues-i/ja mund t’u drejtojë nxënësve: Kë shikoni në fotografi? Ku janë fëmijët? Çfarë po bëjnë ata? Pse shojja po e ndihmon shokun? Çfarë mendoni se i thotë shoku shoqes që po e ndihmon në mësim? Po ju a i ndihmoni shokët apo shoqet në mësim? A ju ndihmojnë ata /ato ju? Çfarë mësojmë nga kjo situatë?

– **Situata 3 – Gjyshja e falënderon vajzën që e ndihmon për të kaluar rrugën.**

– Pyetjet që mësues-i/ja mund t’u drejtojë nxënësve: Kë shikoni në fotografi? Ku janë ata? Çfarë tregon semafori? Po vijat e bardha në rrugë? Çfarë po bën vajza? A e falënderoi e moshuara vajzën? Si mund ta ketë falënderuar? Çfarë mendoni për sjelljen e vajzës? Po ju, si do të kishit vepruar? Si duhet të sillemi ndaj të moshuarve? Çfarë mësojmë nga kjo situatë?

– *Tregohet kujdes që gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehën saktë dhe me fjali të plota.*

Reflektim

Hapi III

Ora përfundon me një nga këto aktivitete:

- Nxënësit tregojnë situata të ngjashme nga jeta e përditshme;
- Nxënësit luajnë me role situata të ngjashme me ato në tekstin mësimor;
- Nxënësit në grupe vlerësojnë në mënyrë kritike sjelljen e personazheve dhe përdorimin e fjalëve magjike në situatat e paraqitura me videoprojektor;

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për zbatimin e rregullave të mirësjelljes dhe përdorimin e shprehjeve: Urdhëro! Faleminderit!

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____



MËSIMI 6

SI T'U DREJTOHEMI TË RRITURVE (ZONJË, ZOTËRI, XHAXHI, TETA)

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Si t' u drejtohem të rriturve (zonjë, zotëri, xhaxhi, teta)?

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zbatojë rregullat e mirësjelljes dhe të përdorë shprehjet përkatëse;
- kur dhe si t'i drejtohet dikujt me respekt
- kë të quajë zonjushë/zonjë/zotëri...

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim, lojë me role

Format e punës: punë frontale, në çift ose grup, individuale

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë fjalët: zonjë, zotëri, xhaxhi, teta, Ju etj.;
- komentojnë dhe diskutojnë me shokët situatat e paraqitura në tekst;
- shprehin lirshëm dhe saktë mendimin e tyre;
- improvizojnë situata duke marrë pjesë në lojërat për ushtrimin e komunikimit;
- vlerësojnë në mënyrë kritike sjelljet e personave në ilustrime nga përvoja vetjake.

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ

Fjalë kyçe: Ju, Ju lutem, Zonjë, Zotëri, Zonjushë, xhaxhi, teta

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, foto me situata, tabelë, ngjitës etj.

Evokim

Hapi I - Veprimtari paraprake

- Nxënësit aktivizohen në bisedë duke u përgjigjur me përgjigje të plota në pyetjet që u drejton mësuesi: Cilët janë anëtarët e familjes suaj? Si u drejtoheni atyre? Si u drejtoheni të rriturve të panjohur? Po mësues-it/eses si duhet t'i drejtoheni? etj.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

- Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi “ **Si t' u drejtohem të rriturve (zonjë, zotëri, xhaxhi, teta)?**”
- Nxënësit për disa minuta vëzhgojnë ilustrimet në faqen 17 dhe diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas përgjigjen në pyetjet që u drejton mësues-i/ja për situatat e paraqitura.
- **Situata 1 - JU LUTEM ZONJË, URDHËRONI ULUNI!**
Pyetjet që mësues-i/ja mund t'u drejtojë nxënësve: Kë shikoni në fotografi? Çfarë po bën vajza? Si i drejtohet ajo gruas pranë? Po ju, si do të kishit vepruar? Kujt i drejtohem me “Zonjë” “Zonjushë”? Kur përdorim shprehjen: **Urdhëro!** Çfarë mësuam nga kjo situatë?

Vihet theksi te përdorimi i fjalëve: **“Urdhëro”, “Zonjë”, “Zotëri”**.

Nxënësit tregojnë situata të tjera, kur ata kanë përdorur këto fjalë apo kanë dëgjuar të tjerët duke i përdorur.

– **Situata 2 - JU LUTEM, ZOTËRI SA ËSHTË ORA?**

Pyetjet që mësues-i/ja mund t’u drejtojë nxënësve: Kë shikoni në fotografi? Çfarë e pyeti djali burrin e panjohur? Si iu drejtua djali atij? Cilat fjalë përdori? Pse i përdori këto fjalë? Po ju, si do të kishit vepruar? Kujt i drejtohem me **“Zotëri”**? Kujt i drejtohem me **“Ju”** dhe **“Ju lutem”**? Çfarë mësuam nga kjo situatë?

Vihet theksi te përdorimi i fjalëve: **“Ju”, “Ju lutem”, “Zotëri”**.

Nxënësit tregojnë situata të tjera kur ata kanë përdorur këto fjalë apo kanë dëgjuar të tjerët duke i përdorur.

– **Situata 3 - TË LUTEM, XHAXHI CILA ËSHTË RRUGA PËR NË KINEMA?**

Pyetjet që mësues-i/ja mund t’u drejtojë nxënësve: Kë shikoni në fotografi? Çfarë e pyeti djali xhaxhin? Si iu drejtua djali atij? Cilat fjalë përdori? Po ju, si do të kishit vepruar? Kujt i drejtohem me **“Të lutem”** dhe **“xhaxhi”**? Çfarë mësuam nga kjo situatë?

Vihet theksi te përdorimi i fjalëve: **“Të lutem”, “xhaxhi”, “teto”**.

Tregohet kujdes që gjatë përgjigjeve, nxënësit të shprehen saktë dhe me fjali të plota.

Nxënësit tregojnë situata të tjera, kur ata kanë përdorur këto fjalë apo kanë dëgjuar të tjerët duke i përdorur.

Ndiqet e njëjta veprimtari për të komentuar situatat e tjera.

Hapi III

Mbas komentimit të situatave nxënësit/et në çifte i drejtojnë njëri-tjetrit pyetjet: Kur dhe si i drejtohem dikujt me respekt? Kur dhe si i lutem dikujt për diçka?

Reflektim

Hapi IV – Dramatizim (punë në grupe)

Nxënësit/et në grupe ose çifte sipas situatave improvizojnë lojë me role ku ai/ajo ata/ato u drejtohet/en të rriturve me fjalët: **“ZOTËRI”, “ZONJË”, “ZONJUSHË”, “JU”, “JU LUTEM”, “XHAXHI”, “TETO”** etj.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____



MËSIMI 7

KËRKOJMË FALJE

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Kërkojmë falje

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zbatojë rregullat e mirësjelljes dhe të përdorë shprehjet përkatëse;
- kur dhe si t'i kërkojë falje dikujt për diçka.

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: pyetja e ditës, bisedë, diskutim, lojë me role

Format e punës: punë frontale, në çift, individuale

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë fjalët: Më fal! Më falni!
- komentojnë dhe diskutojnë me shokët situatat e paraqitura në tekstin mësimor;
- shprehin lirshëm dhe saktë mendimin e tyre;
- improvizojnë situata duke marrë pjesë në lojërat për ushtrimin e komunikimit;
- vlerësojnë në mënyrë kritike sjelljet e personave në situatat e paraqitura në tekst nga përvoja vetjake.

Korrelacion: natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ

Fjalë kyçe: Më fal! Më falni!

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fotografi të ndryshme, tabelë, hamer, ngjithës, ngjyra, kompjuter, videoprojektor etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

- Nxiten nxënësit të bëjnë një koment të shkurtër në pyetjen:
- **Çfarë bëni kur gaboni?**

Diskutohen disa nga përgjigjet që mund të japin nxënësit:

- Kërkoj falje për gabimin që kam bërë.
- Këshilloj të tjerët të mos veprojnë si unë.
- Nuk e përsëris më të njëjtin gabim.
- Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe komentojnë këngën “Dy dhe dy bëjnë tre”.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi **“Kërkojmë falje”**.

- Nxënësit për disa minuta vëzhgojnë ilustrimet në faqen 18 dhe diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas përgjigjen në pyetjet që u drejton mësues-i/ja për situatat e paraqitura:

– **Situata 1- Më fal për vonesën! A mund të hyj?**



Disa nga pyetjet që mund t’u drejtojë mësues-i/ja nxënësve: Në ç’vend paraqitet situata (ngjarja) ? Kush është te dera? Ku janë nxënësit e tjerë? Pse djali qëndron te dera? Çfarë mendoni a e kuptoi djali gabimin? Çfarë mendoni se i tha ai mësueses? A veptoi mirë djali? Si do të kishit vepruar ju? Çfarë mësuam nga kjo situatë?

- Nxirret mesazhi i situatës dhe shprehja “Më fal”!

– **Situata 2 – Na fal për zhurmën, gjyshi!**

Disa nga pyetjet që mund t’u drejtojë mësues-i/ja nxënësve: Në ç’vend paraqitet situata (ngjarja)? Çfarë po bëjnë fëmijët? Cila kohë është gjatë ditës? Çfarë mendoni a e kuptuan fëmijët gabimin? Çfarë i thanë ata të moshuarit? Si do të kishit vepruar ju? Çfarë mësuam nga kjo situatë? etj.

- Nxirret mesazhi i situatës dhe shprehja “Na fal”!

– **Situata 3 – Më fal! Fëmija i kërkon falje shoqes që e ka vënë në lojë për syzet.**

Disa nga pyetjet që mund t’u drejtojë mësues-i/ja nxënësve: Në ç’vend paraqitet situata (ngjarja)?

Kë shihni në fotografi? Cili nga fëmijët ka syze? Si po sillet shoku me të? Si do të vepronit ju? A keni ju shokë apo shoqe që mbajnë syze? Si duhet të sillemi ndaj shokëve e shoqeve që janë ndryshe nga ne? (fëmijëve që kanë vështirësi në shikim, në dëgjim, në të folur a ndaj fëmijëve romë) etj.

- Nxirren disa mësim nga situata :
 - a. Asnjëherë nuk duhet të përqeshim ose përbuzim fëmijët që janë ndryshe nga ne.
 - b. T’i pranojmë në shoqërinë tonë këta fëmijë.
 - c. Të luajmë së bashku lojëra të ndryshme.
 - d. T’i ndihmojmë fëmijët që janë ndryshe nga ne.
- Mësues-i /ja këtu mund të tregojë situata të tjera të fëmijëve me aftësi ndryshe dhe sjelljes që duhet të tregojmë ndaj tyre (paraqitje përmes fotografive që i ngjit ne tabelë/ hamer apo videoprojektorit).

Reflektim

Hapi III

Zhvillohet një nga këto aktivitete:

- Nxënësit tregojnë situata nga jeta e përditshme, kur ata kanë bërë një veprim të gabuar dhe si kanë vepruar.
- Nxënësit në grupe ose çifte improvizojnë para klasës situata të ndryshme të përzgjedhura nga ata vetë ose të ndihmuar nga mësues-i/ja. Paraqitja e situatave mund të bëhet edhe përmes videoprojektorit.

Hapi IV

Detyrë - Vizatoni një situatë, ku ju i kërkon falje prindit/shokut/mësuesit për ndonjë gabim që keni bërë.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____



MËSIMI 8

FJALËT MAGJIKE

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Fjalët magjike

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të zbatojë rregullat e mirësjelljes dhe të përdorë shprehjet përkatëse;
- kur, si dhe kë të falënderojë për diçka;
- kur dhe si t'i kërkojë falje dikujt për diçka;
- kur dhe si t'i drejtohet dikujt me respekt;

Tipi i orës: orë për përforsim njohurish

Metodat dhe teknikat: brainstorming, diskutim, truri i galerisë

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ, muzikë

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë fjalët magjike;
- komentojnë sjelljet dhe punojnë ushtrimet;

Fjalë kyçe: fjalë magjike

Mjetet e mësimi: fotografi të ndryshme, tabelë, ngjites, teksti mësimor, laps, ngjyra etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Plotësohet skema gojarisht nga nxënësit.



Diskutim me nxënësit, kur i përdorim fjalët magjike dhe pse?

*Nxënësit dëgjojnë dhe këndojnë këngën "Fjalëzat magjike".

(https://youtu.be/D7iBX_r_Grc?si=xYDXDW8beobYiQVD).

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë me tekstin mësimor

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi "**FJALËT MAGJIKE**".

- Nxënësit për disa minuta vëzhgojnë ilustrimet në faqen 19 dhe diskutojnë me njëri - tjetrin. Më pas komentojnë sjelljet dhe punojnë detyrat (ushtrimet).

Ushtrimi 1.

Në cilën situatë përdorim fjalët magjike? Nxënësit tregojnë situatën dhe japin argumente. Mësues-i/ja mund të pyesë nxënësit: Cila sjellje u duket e duhura dhe pse? Si do të kishit vepruar ju?

Ushtrimi 2. Ngjyrosin me të verdhë fjalët magjike dhe me ngjyrë tjetër fjalët e tjera. (Lexojnë kërkesën me ndihmën e mësuesit).

Reflektim

Hapi III – Truri i galerisë

- Nxënësit punojnë ushtrimin e fundit.
- Vizatojnë një situatë ku ata kanë përdorur fjalët magjike.

Në fund punimet i vendosin në një kënd të klasës dhe vëzhgojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësim: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 9

SI TË UROJMË?

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Si të urojmë?

Arritjet e të nxëniet:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë dhe shpjegojë situatat kur, si dhe kujt i urohet apo i shprehet mirënjohje për diçka, si dhe të zbatojë rregullat e mirësjelljes gjatë shprehjes së urimeve dhe mirënjohjeve.

Tipi i orës: orë për përvetësimin e njohurive

Metodat dhe teknikat: Rri rrotull - fol rrotull, Diagrami i Venit, krijim, demonstrim

Format e punës: punë frontale, në çift, individuale

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, matematikë, Kultura e artit figurativ, edukatë fizike, muzikë

Aktivitetet e nxënësve:

- vëzhgojnë dhe komentojnë materialin e paraqitur me videoprojektor;
- komentojnë dhe diskutojnë me shokët situatat e paraqitura në tekstin mësimor;
- punojnë urime të thjeshta me materiale të ndryshme.

Fjalë kyçe: uroj, urim, U bëfsh..!

Mjetet e mësimi: fotografi të ndryshme, tabelë, ngjitës, teksti mësimor, laps, ngjyra etj.

Evokim

Hapi i parë – Veprimtari paraprake

- Nxënësit lihen disa minuta të vëzhgojnë fotot (ilustrimet) e paraqitura me videoprojektor:
- Sot kam ditëlindjen.
- Albani zuri vendin e parë në garat e baletit.
- Nëna nesër do të festojë 8 Marsin.

Hapi II – Rri rrotull - fol rrotull

- Nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe kur mësuesja përplas duart një herë, ata ndalojnë dhe krijojnë çifte me shokun që kanë më afër. Çiftet zhvillojnë një dialog lidhur me situatat e paraqitura në videoprojektor.
- Njëri thotë situatën, kurse tjetri duhet të urojë. p. sh.:
- Sot kam ditëlindjen.
- **Gëzuar ditëlindjen!**
- Kështu vazhdohet me të gjitha situatat. Mësuesja i nxit nxënësit të thonë sa më shumë urime.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimit “ **Si të urojmë?**”

- Nxënësit për disa minuta vëzhgojnë ilustrimet në faqen 21 dhe diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas përgjigjen në pyetjet që u drejton mësues-i/ja për situatat e paraqitura.

Komentohet figura e parë

- Mësues-i/ja mund t’iu drejtojë nxënësve këto pyetje: Kë shikoni në fotografinë e parë? Çfarë po festojnë fëmijët? Si duhet t’i urojmë ata? Po ju apo ndokush nga familja juaj a ka fituar çmim në gara të tilla? etj.

Komentohet figura e dytë

- Mësues-i/ja mund t’iu drejtojë nxënësve këto pyetje: Çfarë festojnë fëmijët në fotografinë e dytë? A gëzoheni ju kur vjen 1 Qershori? Pse? Si e uroni njëri-tjetrin për këtë festë? etj.

Komentohet figura e tretë

- Mësues-i/ja mund t’iu drejtojë nxënësve këto pyetje: Kush ka ditëlindjen? Pse është e gëzuar gjyshja? Çfarë dhuratash ka fituar ajo? Si e urojnë fëmijët gjyshen për ditëlindje? Cila është kënga e ditëlindjes? Po ju a gëzoheni kur gjyshja ka ditëlindjen? Çfarë i dhuron asaj? etj.

Komentohet figura e katërt

- Mësues-i/ja mund t’iu drejtojë nxënësve këto pyetje : Kë shikoni në fotografi? Çfarë po festojnë fëmijët? A gëzoheni ju kur vinë festat e fundvitit? Si e uroni njëri-tjetrin për këto festa? Çfarë dhuratash fitoni? etj.

Hapi IV

Mbi bazën e komentimit të situatave së bashku me nxënës arrihet në këto përfundime:

***Urime dërgojmë për festa të ndryshme (për ditëlindje, Vitin e Ri, Pashkët...),për suksese në mësimet etj.**

***Urimet mund t’i bëjmë me gojë ose shkrim.**

Reflektim

Hapi V – Diagrami i Venit, krijim, diskutim

Zhvillohet një nga këto aktivitete:

Aktiviteti 1

Çdo nxënës ka sjellë foto nga: ditëlindja e tij, festa fetare, festat e fundvitit, çmimet e fituara në gara etj. dhe tregon çastet më të bukura të asaj dite. Ata me anë të fotografive do të krijojnë ngjarje. Tregojnë për urimet që kanë marrë.

Aktiviteti 2

Nxënësit me anë të Diagramit të Venit krahasojnë festimin e 1 Qershorit në libër (ditëlindjes së gjyshes, festimit të fitores në mësimet etj.) me festimin e 1 Qershorit në shkollë apo vendlindjen e tyre (ditëlindjen e gjyshes së tyre, festimit të fitores së tyre në gara apo të familjarëve etj.). Flasin për urimet e bëra.

Të veçantat

Të përbashkëtat

Të veçantat



Gjatë punës mësues-i/ja i kontrollon dhe ndihmon nëse e shikon të nevojshme.

Hapi VI – Demonstrim

Punojnë detyrën e dhënë në tekstin mësimor.

Detyrë - Vizato një kartolinë urimi dhe me ndihmën e mësuesit /prindit vendosni (ngjiteni duke e prerë diku/shkruajeni) një urim.

Gjatë punës nxënësit mund të dëgjojnë një nga këto këngë për fëmijë: “Ja na erdhi Viti i Ri”/”Shumë urime për ty”/”Zëri yt moj gjyshe” etj.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____

2. DËGJOJMË DHE DALLOJMË TINGUJT E SHKRONJAT



MËSIMI 10

DALLOJMË TINGUJT E ARTIKULUAR

Lënda : Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Dallojmë tingujt e artikuluar

Arritjet e të nxëniti:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, shpjegim, demonstrim

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore

Aktivitetet e nxënësve:

- komentojnë dyfletëshin
- dëgjojnë dhe krahasojnë tingujt e ndryshëm;
- identifikojnë përmes shembujve dallimin në mes tingullit dhe shkronjës;
- përshkruajnë fotot dhe shqiptojnë saktë tingujt;
- punojnë të pavarur ushtrimet e dhëna në tekstin mësimor.

Fjalë kyçe: tinguj të përftuar në natyrë, tinguj të artikuluar , tingull, shkronjë

Mjetet e mësimi: kompjuter, CD, teksti mësimor, figura, ngjyra, mjete demonstrimi (lodër, fyell, zile, bilbil etj.)

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje tinguj të ndryshëm në CD. Më pas tregojnë, se ku i kanë dëgjuar këta tinguj (fishkëllima e erës, bubullima, përplasja e duarve, boria e makinës, sendi kur bie në tokë, tingujt që lëshojnë veglat muzikore etj.) dhe si përftohen ata.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri


Mësuesja shkruan në tabelë titullin e mësimi **“Dallojmë tingujt e artikuluar”**.

Nxënësit hapin tekstin mësimor në faqen 24 dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit nga mësuesja. Më pas e komentojnë atë .

Tingujt dhe shkronjat

Tingujt mund të përftohen në natyrë, si tingulli që bëjnë valët e detit apo era kur fryn. Kemi edhe tinguj që përftohen nga një instrument muzikor, si tingulli që lëshon daullja, pianoja etj. Po tinguj


kemi edhe në gjuhë. Ata krijohen gjatë të folurit. Gjuha e folur përbëhet nga tinguj, ndërsa gjuha e shkruar nga shkronjat. Alfabeti i gjuhës shqipe ka 36 shkronja.



Mësuesja shpjegon dallimin në mes **tingullit** dhe **shkronjës**.

Hapi III

- Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë figurat tek **ushtrimi i parë** dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas ata shqiptojnë tingullin me të cilin fillon fjala dhe e lidhin me shkronjën e duhur.
- **Shembull:**



A

Demonstrohet dallimi tingull-shkronjë.

Reflektim

- Nxënësit pas shpjegimit të mësuesit punojnë **ushtrimin e dytë**:
- Shqiptojmë. Vështrojmë. Krahasojmë.
- Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____



MËSIMI 11, 12

SHPORTA E TINGUJVE DHE E SHKRONJAVE 1, 2

Lënda : Gjuhe shqipe dhe letërsi

Fusha : Gjuhë

Njësia e mësimi: Shporta e tingujve dhe e shkronjave

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;

Tipi i orës: orë për përvetësim/përforcim të njohurive (**2 orë**)

Metodat dhe teknikat: bisedë, vëzhgo - diskuto, shpjegim, analizë

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: Kultura e artit figurativ, edukatë muzikore

Aktivitetet e nxënësve:

- dëgjojnë, këndojnë dhe komentojnë këngën e alfabetit;
- përshkruajnë fotot dhe shqiptojnë saktë tingujt;
- punojnë të pavarur ushtrimin e dhënë në tekstin mësimor.

Fjalë kyç: shkronjë, tingull

Mjetet e mësimi: CD, magnetofon, kompjuter, foto, tabelë, ngjitës, teksti mësimor, mjete vizatimi, kompjuter, videoprojektor, tablo etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë dhe këndojnë këngën për fëmijë “Kënga e alfabetit”. Më pas nxiten të përshkruajnë atë duke u ndihmuar me pyetjet: A u pëlqeu kjo këngë? A e keni dëgjuar më parë këtë këngë? Nëse po, ku? Kujt i kushtohet kjo këngë? A keni mësuar ju për shkronjat në parashkollor? A di ndokush nga ju ndonjë shkronjë? (Nëse ka nxënës që dinë ndonjë shkronjë, ato shkruhen në tabelë nga ata dhe tregohen fjalë që fillojnë me ato shkronja).

Hapi II - vëzhgo – diskuto

Lihen nxënësit të vëzhgojnë për disa minuta fotot e paraqitura me videoprojektor: **ananas**, **mollë**, **portokall**. Më pas nxiten t’i përshkruajnë ato duke u ndihmuar nga pyetjet: Çfarë shikon në videoprojektor? Çfarë janë ato? A ju pëlqejnë ju këto fruta? Cili frut ju pëlqen më shumë? Kush di nga ju me cilën shkronjë fillon fjala **ananas**? Po molla? Po portokalli? Shqiptohen këta tinguj nga nxënësit dhe mësuesja paralelisht poshtë fotografive shkruan shkronjat **A**, **M** dhe **P**.

Tërheq vëmendjen e nxënësve të shqiptimi i saktë dhe i qartë i tingujve.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri (analizë, shpjegim)

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi “**Shporta e tingujve dhe e shkronjave**”.

Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë fotografitë në faqen 25 dhe të diskutojnë me njëri – tjetrin. Më pas nxiten të përshkruajnë figurën e parë duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë shikoni në figurën e parë? A ju pëlqen akullorja? Me cilin tingull fillon emri i saj? (Njohuri paraprake nga parashkollorja).

Nëse nxënësit kanë vështirësi në gjetjen e tingullit (shkronjës), mësues-i/ja i ndihmon. Mësuesi shpjegon se fjala **AKULLORE** fillon me tingullin (shkronjën **A**). Bën lidhjen e tingullit me shkronjën dhe e qarkon shkronjën **A** në fjalën e dhënë. Shqiptohet ajo nga nxënësit.



A

AKULLORE

Kështu vepron edhe me shkronjat e tjera duke i njohur nxënësit në mënyre globale me shkronjat e alfabetit. Tërhiqet vëmendja e nxënësve te shqiptimi i saktë dhe i qartë i tingujve. Ndhmon nxënësit, të cilët kanë vështirësi në shqiptimin e ndonjë tingulli.

Për lexim dhe shqiptim të tingujve mësues-i/sja mund të përdorë këtë adresë: <https://youtu.be/GOyoZ3xCjLM>

Mësues-i /ja mund ta paraqesë në një tablo ose me videoprojektor faqen 17 të tekstit mësimor apo të shkëpusë ndonjë shembull të dhënë. Më pas vazhdon punën me tekst.

Reflektim

Hapi IV

- Nxënësit punojnë ushtrimin e dhënë në tekst, pasi mësues-i/ja lexon kërkesën dhe shpjegon atë.

Ushtrimi. Nxënësit shkruajnë shkronjat duke kaluar lapsin mbi vijat e ndërprera dhe më pas i ngjyrosin ato.

Gjatë punës mësues-i/ja i ndjek dhe i ndihmon nëse e sheh të nevojshme.

Puna mund të vazhdohet edhe në shtëpi.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____



MËSIMI 13

TINGUJ TË NJËJTË - RIMA

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Tinguj të njëjtë - rima

Arritjet e të nxëniet:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

*të vërejtë përputhjen tingullore të fjalëve të veçanta - rimën;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, shpjegim, diskutim, analizë, truri i galerisë

Format e punës: punë frontale, individuale, në grup, në çift

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore, Kultura e artit figurativ **Aktivitetet e nxënësve:**

- dëgjojnë, këndojnë dhe analizojnë këngën “Moj bubrrec”;
- dallojnë fjalët që rimojnë;
- punojnë të pavarur ushtrimin e dhënë në teksti mësimor;
- marrin pjesë në lojëra për zhvillimin e ndjeshmërisë tingullore (dëgjojnë, përsërisin dhe mësojnë vjersha me rimë etj)
- vizatojnë sende ose qenie, emrat e të cilëve/cilave rimojnë.

Fjalë kyçe: tinguj të njëjtë, rima

Mjetet e mësimi: CD, kompjuter, tekst mësimor, tabelë, shkumës, laps, gomë, fletore, ngjyra etj.

Evokim

Hapi I - Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë dhe këndojnë këngën për fëmijë “**Moj bubrrec**” (<https://youtu.be/v95eu-gHfml4>). Më pas dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit të këngës nga mësues-i/ja:

Moj bubrrec, moj bubr**ec**,
ti gjithë ditën rrin tuj **ec**,
mbledh e mbledh e grumbull**on**,
a thu vallë për mu pun**on**,
moj bubrrec po vi me t’**pa**,...
një varg grunë ma jep **hua**
se t’a laj porsa t’vij **vera**,
për një varg t’jap dy të tjera
(Sipas Lajde Stakut)

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimit **“Tinguj të njëjtë - rima”**. Më pas orienton nxënësit të vënë re se disa nga fjalët e këngës i kanë tingujt e njëjtë.

*Lexon nga dy vargje dhe kërkon nga nxënësit të veçojnë fjalët, që rimojnë. Përsëriten nga nxënësit në çifte dhe grupe - çiftet e fjalëve që rimojnë. Mësues-i /ja me shkronja të mëdha shtypi mund t'i shkruajë në tabelë këto çifte fjalësh (**BUBRREC - EC, GRUMBULLON - PUNON, VERA - TJERA**).

Hapi III – analizë

Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë fjalët e dhëna në faqen 28 dhe të diskutojnë me njëri - tjetrin. Më pas punojnë **ushtrimin e parë**, pasi mësuesi lexon dhe shpjegon kërkesën.

Ushtrimi 1. Ngjyrosin me ngjyrë të njëjtë fjalët, që kanë përbërje tingullore të njëjtë.

– **Shembull:** **TOPI – TOPI**

TRENI – TRENI

Ushtrimi 2. Nxënësit emërtojnë figurat në çdo rresht dhe qarkojnë ato që rimojnë. Nëse kanë vështirësi mund të ndihmohen nga shokët ose mësuesja.

– Shembull **ARKA - MASKA** **KALI - DJALI** etj.

Reflektim

Hapi IV – recitim, analizë, truri i galerisë

Ora përfundon me një nga këto aktivitete:

Aktiviteti 1

Nxënësit vullnetarë recitojnë vjersha të ndryshme me rimë dhe të tjerët dallojnë tingujt e njëjtë (rimën) tek fjalët e veçanta. Nëse kanë vështirësi ndihmohen nga njëri - tjetri ose mësues-i/ja.

Aktiviteti 2

Nxënësit në çifte vizatojnë nga dy sende ose qenie, emrat e të cilëve/cilave rimojnë.

Në fund punimet i vendosin në një kënd të klasës dhe vëzhgojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 14

PËRBËRJA TINGULLORE E FJALËS. TINGUJ TË NDRYSHËM

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj të ndryshëm

Arritjet e të nxëniti:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

* të gjejë në çiftet e fjalëve të ngjashme shkronjën e cila dallon dhe të tregojë se ajo shkronjë e ndryshon kuptimin e fjalës;

* të shpjegojë përbërjen tingullore të fjalës;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, lojë enigmë, shpjegim, analizë

Format e punës: punë frontale, individuale, në grup, në çift

Korrelacioni: matematikë, natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore, Kultura e artit figurativ

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë përmes lojës tingujt (shkronjat) e ndryshme në çiftet e fjalëve të dhëna;
- numërojnë tingujt (shkronjat) e një fjale;
- punojnë në çifte ushtrimin e dhënë në teksti mësimor;
- punojnë në çifte ose grupe me shkronjat lëvizore.

Fjalë kyçe: tingull, shkronjë, tinguj të ndryshëm

Mjetet e mësimi: CD, kompjuter, teksti mësimor, tabelë, shkumës, laps, gomë, fletore, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

- Nxënësit dëgjojnë me vëmendje këngën “Vallja e shkronjave” dhe më pas me fjalët e tyre shpjegojnë se çfarë kuptojnë me fjalën shkronjë.

Hapi II – lojë enigmë

- Mësues-i /ja ka futur brenda në një kuti **një fletë** dhe brenda një kutie tjetër **një bletë (lodër)**. U kërkon disa nxënësve të fusin dorën në kuti dhe të prekin sendet dhe të tregojnë se çfarë është mbi bazën e prekjës. Në fund mësues-i/ja nxjerr nga kutia sendet dhe ua tregon nxënësve.

Realizim kuptimi

Hapi III - Informacion i ri (shpjegim, analizë)

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi “ **Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj të ndryshëm**”.

Dy nxënës vullnetarë ngjisin në tabelë figurën e bletës, poshtë së cilës është shkruar fjala **BLETA**, ku shkronja **B** është me ngjyrë tjetër. Po ashtu ngjisin edhe figurën e fletës, poshtë së cilës është shkruar fjala **FLETA**, ku **F** është me ngjyrë tjetër.

Nxënësit e tjerë i shqiptojnë këto dy fjalë dhe përgjigjen në pyetjet: Me çfarë fillon fjala e parë? Me çfarë fillon fjala e dytë? Nëse nxënësit kanë vështirësi ndihmohen nga mësues-i/ja. *Bëhet analiza tingullore e fjalëve së bashku me nxënës, ku ata dallojnë se çdo fjalë përbëhet nga 5 tinguj (shkronja). Tërhiqet vëmendja e nxënësve të shkronjat **B** dhe **F**. Bëhet lidhja tingull - shkronjë. Nxënësit krahasojnë fjalët dhe arrijnë në përfundim se në këto dy fjalë shkronja të ndryshme janë: **B** dhe **F**.

Përmes këtij aktiviteti synohet, që nxënësit të dallojnë shkronjat (tingujt) që janë të ndryshme në çiftet e fjalëve të dhëna, si dhe të kuptojnë sa tinguj (shkronja) ka çdo fjalë.

Hapi IV

Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë figurat në faqen 30 dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas ata komentojnë përbërjen tingullore të fjalëve të paraqitura përmes tabelave (korrelacion me matematikë).

- *Mësues-i/ja shpjegon përbërjen tingullore të fjalëve të dhëna duke ua tërhequr vëmendjen nxënësve tek numri i tingujve (shkronjave) që ka çdo fjalë.

A	1
R	2
A	3

Shembull



ARA

Hapi V

Punohet ushtrimi nga nxënësit në çifte. Nxënësit shqiptojnë dhe krahasojnë çiftet e fjalëve të dhëna. Shpjegojnë përbërjen tingullore të fjalëve. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Shembull



DIELL



MIELL

Reflektim

Hapi VI – Punë në çifte ose grupe

Organizohet punë në çifte ose në grupe me shkronja lëvizore, ku nxënësit të ndihmohen nga mësues-i/ja gjejnë çifte fjalësh që dallojnë në një shkronjë ose më shumë.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 15, 16

TINGUJ TË NJËJTË - TINGUJ TË NDRYSHËM 1, 2

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimit: Tinguj të njëjtë - Tinguj të ndryshëm I, II

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;
- të vërejë përputhjen tingullore të fjalëve të veçanta - rimën;
- të gjejë në çiftet e fjalëve të ngjashme tingullin që dallon dhe të tregojë se ai tingull ndryshon kuptimin e fjalës;
- të shpjegojë përbërjen tingullore të fjalës.

Tipi i orës: orë për përforsim njohurish (2 orë)

Metodat dhe teknikat: bisedë, analizë, lexim i drejtuar

Format e punës: punë frontale, individuale, në grup, në çift

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, kulture muzike, Kultura e artit figurativ, matematikë

Aktivitetet e nxënësve:

- dallojnë fjalët që rimojnë;
- identifikojnë tingujt (shkronjat) e ndryshme në çiftet e fjalëve të dhëna;
- numërojnë tingujt (shkronjat) e një fjale;
- punojnë të pavarur ushtrimet e dhënë në tekstin mësimor;
- marrin pjesë në lojëra për zhvillimin e ndjeshmërisë tingullore (dëgjojnë, përsërisin dhe mësojnë vjersha me rimë etj).

Fjalë kyçe: tingull, shkronjë, tinguj të ndryshëm

Mjetet e mësimit: CD, kompjuter, teksti mësimor, tabelë, shkumës, laps, gomë, fletore, mjete vizatimi etj.


Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësve u propozohen fjalë e ato mund të gjenë fjalë të tjera që përputhen me tinguj/ ose mund t' i lexohet ndonjë pjesë me rimë (p. sh. "Rosaku").

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë me tekstin mësimor Nxënësit vëzhgojnë figurën e dhënë në fillimit të faqes 24 dhe me vëmendje dëgjojnë tekstin e lexuar nga mësuesja. Më pas e komentojnë atë.



Rosat dhe patat

Rosat dhe patat mbahen kryesisht si shpend uji. Ka lloje të ndryshme të patave dhe rosave. Ata mund të jenë shpend të egjër ose edhe të butë. Prej shumë shekujsh patat dhe rosat janë zbutur dhe mund të jenë edhe kafshë shtëpiake. Njerëzit i njohin ato për mishin e tyre, vezët dhe puplat me të cilat mund të mbushen jorganë, dyshekë etj. Patat janë roje të mira në oborrin e fermës, sepse ata fillojnë të bëjnë ga-ga-ga sapo vinë të panjohur.

Hapi III

*Në tekstin mësimor faqe 32 nxënësit punojnë të pavarur ushtrimet e dhëna (një nga një), pasi mësues-i/ja lexon kërkesat dhe i shpjegon ato.

Ushtrimi 1- Ngjyrosin tingujt e njëjtë në fjalë.

Shembull

LEJLEK

Ushtrimi 2 - Ngjyrosin tingujt e ndryshëm në fjalë.

Shembull



ARA

Ushtrimi 3 – Nxënësit krijojnë figurën e rosakut me laps e pastaj e ngjyrosin sipas modelit (Bashkojnë pikat dhe ngjyrosin figurën).

- Nxënësit që kanë vështirësi në punimin e ushtrimeve ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Reflektim

Hapi IV

- Nxënësit të çifte punojnë ushtrimet e dhëna (një nga një), pasi mësues-i/ja ua lexon kërkesat dhe i shpjegon ato.

Ushtrime – Në çdo rresht gjejnë dhe ngjyrosin figurat, emrat e të cilave rimojnë: RROTA-GO-TA, GRUA- FTUA.

- Në çiftet e fjalëve të dhëna rrethojnë shkronjat që janë të ndryshme.
- Nxënësit ngjyrosin figurën sipas modelit.
- Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 17

PËRBËRJA TINGULLORE E FJALËS. TINGUJ NË FILLIM TË FJALËS 1

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në fillim të fjalës I

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë vendin dhe renditjen e tingujve (shkronjave) në fjalë;
- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;
- të shpjegojë përbërjen tingullore të fjalës.

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, shpjegim

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: matematikë, natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë tingullin (shkronjën) me të cilin fillon fjala;
- identifikojnë me anë të dëgjimit fjalët që përmbajnë tingujt të ndryshëm në fillim të tyre;
- ndajnë fjalët në tinguj përmes lojës (përplasje e duarve);
- punojnë të pavarur detyrat (ushtrimet) në tekstin mësimor.

Fjalë kyçe: tingull, shkronjë, tinguj në fillim të fjalës

Mjetet e mësimi: projektor, kompjuter, teksti mësimor, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

- Nxënësit vëzhgojnë foton e lepurit të pasqyruar me projektor dhe nxiten ta përshkruajnë atë të ndihmuar me pyetjet:
- Çfarë shihni në figurë?
- Keni parë ndonjëherë lepur?
- Ku e keni parë?
- Çfarë dini për lepurin?
- Cili prej jush ma ndan në tinguj këtë fjalë?
- Sa kuti duhet të ngjyrosim?
- Fjala **LEPUR** ka pesë tinguj dhe ne do të ngjyrosim pesë kuti.
- Me çfarë tingulli fillon fjala lepur?

Mësues-i/ja pyet nxënësit se kujt i fillon emri me këtë tingull të ngrejë dorën dhe organizon diskutimin duke ndrequr në bashkëpunim me nxënësit gabimet eventuale që mund të vi-

hen re.

*Nxënësit tregojnë fjalë të tjera që fillojnë me këtë tingull.

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësuesja shkruan në tabelë titullin e mësimit “ **Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në fillim të fjalës I’.**

- Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë figurat në faqen 36 dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas nxiten ta emërtojnë figurën e parë dhe ta përshkruajnë duke u ndihmuar nga pyetjet:

Çfarë shihni në figurë? A keni qenë ndonjëherë në det? A ju pëlqen deti? Pse? Me çfarë tingulli fillon fjala det? A dini fjalë të tjera që fillojnë me këtë tingull? Cili prej jush ma ndan në tinguj këtë fjalë? Fjala në tinguj mund të ndahet me përplasje të duarve. Fjala **DETI** ka katër tinguj:

D-E-T-I



DETI

D	E	T	I
1	2	3	4

Përsëritet e njëjta veprimtari për shembujt e tjerë.

Reflektim

Hapi III

- Nxënësit të pavarur punojnë fletën me ushtrime, që u jep mësuesi. Rrethojnë fjalët që fillojnë me tingujt (shkronjat) e dhëna. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi/ja.

Vlerësim: Nxënësit/et vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 18

PËRBËRJA TINGULLORE E FJALËS. TINGUJ NË FILLIM TË FJALËS 2

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në fillim të fjalës II

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë vendin dhe renditjen e tingujve (shkronjave) në fjalë;
- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;
- të shpjegojë përbërjen tingullore të fjalës.

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim, metoda fonetike-alfabetike

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: matematikë, natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ, matematikë

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë tingullin (shkronjën) me të cilin fillon fjala;
- identifikojnë me anë të dëgjimit fjalët, që përmbajnë tingujt të ndryshëm në fillim të tyre;
- ndajnë fjalët në tinguj përmes lojës (përplasje e duarve);
- punojnë të pavarur detyrat (ushtrimet) në tekstin mësimor.

Fjalë kyçe: tingull, shkronjë, tinguj në fillim të fjalës

Mjetet e mësimi: fotografi të ndryshme, tabelë, ngjithës, teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi i parë – Veprimtari paraprake

Nxënësit emërtojnë fotografitë e ngjitura në tabelë (ARIU, DIELLI, MOLLA, NËNA) dhe tregojnë me cilin tingull (shkronjë) fillojnë ato: ARIU A, DIELLI D etj.

Mbi tavolinë vendosen fotografi të ndryshme, të cilat fillojnë me tingujt e mësipërm (A, D, M, N). Çdo nxënës do të marrë nga një fotografi dhe do ta vendosë poshtë figurës së duhur (ARIU, DIELLI, MOLLA, NËNA).

Në përfundim organizohet diskutim duke ndrequr në bashkëpunim me nxënësit gabimet eventuale që mund të vihen re në tabelë.

Realizim kuptimi

Hapi II - Punë me tekstin mësimor

Mësuesja shkruan në tabelë titullin e mësimi **“Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në fillim të fjalës II”**.

Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë figurat në faqen 38 dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas nxiten ta emërtojnë figurën e parë dhe ta përshkruajnë duke u ndihmuar me

pyetjet:

Çfarë shihni në figurën e parë? Me cilin tingull fillon emri **DJALI**? Cili prej jush ma ndan në tinguj këtë fjalë? Sa tinguj ka? Nxënësit ngjyrosin aq rrathë sa tinguj ka fjala.

Tërhiqet vëmendja e nxënësve në anën e djathtë ku ndodhet kutia e fjalëve me tingullin **D**. Mësues-i/ja lexon fjalët, kurse nxënësit qarkojnë fjalët që fillojnë me atë tingull. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët ose mësuesja.

Përsëritet e njëjta veprimtari edhe me shembujt e tjerë.

Hapi III – Vazhdim i punimit të ushtrimeve

Nxënësit punojnë **ushtrimin e dytë** me ndihmën e mësuesit. Ai shkruan në tabelë shkronjën **G** dhe nxënësit e përshkruajnë atë në libër. Pastaj plotësojnë sa tinguj (shkronja) ka fjala.

GAFORRE

1	2	3	4	5	6
---	---	---	---	---	---

Kështu vazhdohet edhe shembulli tjetër.

Reflektim

Hapi IV

Shembull: K —————→ KALË, KETËR, KAPROLL

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 19

PËRBËRJA TINGULLORE E FJALËS. TINGUJ NË MES TË FJALËS 1

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në mes të fjalës 1

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje :

- të vërejë vendin dhe renditjen e tingujve (shkronjave) në fjalë;
- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;
- të shpjegojë përbërjen tingullore të fjalës;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: lojë enigmë, bisedë, diskutim, metoda fonetike - alfabetike

Format e punës: punë frontale, individuale, në grup, në çift

Korrelacioni: matematikë, natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë tingullin (shkronjën) në mes të fjalës;
- identifikojnë me anë të dëgjimit fjalët, që përmbajnë tinguj të ndryshëm në mes të tyre;
- ndajnë fjalët në tinguj përmes lojës (përplasje e duarve);
- punojnë të pavarur ose në bashkëpunim me mësuesin detyrat (ushtrimet) në tekstin mësimor;
- punojnë në çifte dhe grupe detyrat e dhëna.

Fjalë kyçe: tingull, shkronjë, tinguj në mes të fjalës

Mjetet e mësimi: fotografi të ndryshme, tabelë, ngjitës, hamer, teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi, lodra etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake (lojë enigmë)

*Në një kuti mësues-i/ja ka futur një elefant lodër. U kërkon disa nxënësve të fusin dorën dhe mbi bazën e prekje të tregojnë se çfarë është brenda në kuti. Pasi nxënësit shprehin mendimet e tyre, mësues-i/ja nxjerrë figurën e elefantit, poshtë së cilit është shkruar fjala **ELEFANTI**, ku shkronja **E** është me ngjyrë tjetër dhe kërkon që të gjithë nxënësit të shqiptojnë fjalën **ELEFANTI**.

*Nxënësit përshkruajnë figurën duke u ndihmuar me pyetjet: Me cilin tingull fillon emri elefantit? Sa herë e dëgjoni këtë tingull kur shqiptoni fjalën **ELEFANTI**? Nëse nxënësit nuk arrijnë të japin përgjigjen e duhur, atëherë mësuesi shpjegon se këtë tingull e dëgjojmë dy herë (në fillim dhe në mes).

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësuesja shkruan në tabelë titullin e mësimit **“Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në mes të fjalës I”**.

Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë figurat në faqen 41 dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas nxiten t’i emërtojnë (komentojnë) figurat dhe të përcaktojnë vendin e tingullit **A** në fjalë. Përcaktimin e vendit të tingullit në fjalë, mund ta bëhet edhe përmes lojës **“Stop dhe përjashto”**, ku mësuesi kërkon që nxënësit të thonë stop në fjalët që shqipton dhe ku dëgjohet tingulli **A**.

Përfundim: Tingulli **A** ndodhet në mes të fjalëve .

Nxënësit tregojnë fjalë të tjera, që kanë tingullin **A** në mes.

Nxënësit së bashku me mësuesen komentojnë figurat e tjera dhe përcaktohet vendi i tingullin **O** në emrat e qyteteve, të cilat në figurën e kekut (tortës) janë paraqitur sipas numrit të banorëve. Nxënësit mbi bazën e dëgjimit arrijnë në këtë përfundim: fjala **ROZHAJË** ka një tingull **O** në mes, kurse fjalët **KOTORR** dhe **PODGORICË** kanë dy tinguj **O** në mes.

Ndahen fjalët në tinguj dhe nxënësit plotësojnë me numra katrorët bosh.

Nxënësit tregojnë fjalë të tjera, që kanë tingullin **O** në mes.

Kështu vazhdohet edhe me shembujt e tjerë për tingullin **U** dhe **E**.

Reflektim

Hapi III

Ora përfundon me një nga këto aktivitete:

Aktiviteti 1 (punë në çifte)

Nxënësit në çifte zhvillojnë lojën **“Stop dhe përjashto”** me shembujt të tjerë për tingujt **A**, **O**, **U** dhe **E**. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi/ja.

Aktivitet 2 (punë në grupe).

Nxënësit e ndarë në grupe punojnë së bashku detyrat e përcaktuara nga mësuesi (Çdo grup punon me një tingull të mësuar gjatë orës).

Gr 1. Fluturat

Shembull: Tingulli **O**

Nxënësit ngjisin në hamer vetëm ato figura, emrat e të cilave kanë në mes tingullin **O**.

Çdo lider i grupit prezanton punën e grupit të vet. Nxënësit e grupeve të tjera, ndreqin gabimet (nëse ka të tilla).

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 20

PËRBËRJA TINGULLORE E FJALËS. TINGUJ NË MES TË FJALËS 2

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në mes të fjalës II

Arritjet e të nxëniti:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë vendin dhe renditjen e tingujve (shkronjave) në fjalë;
- të shpjegojë përbërjen tingullore të fjalës;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim , analizë

Format e punës: punë frontale, individuale, në grup, në çift

Korrelacioni: matematikë, natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë me anë të dëgjimit fjalët, që përmbajnë tingujt të ndryshëm në mes të tyre;
- ndajnë fjalët në tinguj përmes lojës (përplasje e duarve);
- krahasojnë tingujt duke i dëgjuar;
- punojnë të pavarur ose në bashkëpunim me mësuesin/en detyrat (ushtrimet) në tekstin mësimor;
- punojnë në grupe detyra të ndryshme;
- shprehin lirshëm mendimet e tyre.

Fjalë kyçe: tingull, shkronjë, tinguj në mes të fjalës

Mjetet e mësimi: fotografi të ndryshme, tabelë, ngjitës, hamer, teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi, fletë me ushtrime etj.

Evokim

Hapi i parë – Veprimtari paraprake

Nxënësit emërtojnë fotografitë e ngjitura në tabelë (**FRUTA, SHITORE, LULE, KETËR, ATLETE**) dhe përcaktojnë pozicionin e tingullit **T** në këto fjalë. Vendoset **X** mbi figurën e futur gabim. Ndhimohen nxënësit nëse është e nevojshme.

Realizim kuptimi

Hapi II - Punë me tekstin mësimor

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi “ **Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në mes të fjalës II**”.

Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë figurat në faqen 43 dhe të diskutojnë me njëri – tjetrin **ushtrimin e parë**. Më pas e punojnë në mënyrë individuale ushtrimin e parë, pasi mësues-i/ja shpjegon kërkesën.

Ushtrimi 1 Nxënësit ngjyrosin figurat ku dëgjojnë tingullin **J** në mes të fjalës (hoje, vajzë, kufje, pjatë). Ngjyrosin aq rrathë sa tinguj ka fjala.

Ushtrimi 2 punohet në bashkëpunim mësues - nxënës. Mësuesi shqipton fjalën dhe orienton nxënësit të tingulli (shkronja) me ngjyrë të kuqe. Nxënësit duke dëgjuar shqiptimin e mësueses përcaktojnë vendin e tingullit **Z, T** në çiftet e fjalëve: **Z**JARR - FISHEK**Z**JARR
ZHY**T**ËS – **T**ELEVIZOR

Shembujt e tjerë të këtij ushtrimi mund të punohen edhe nga nxënësit në çifte të orientuar nga mësuesja. Tërhiqet vëmendja e nxënësve të shqiptimi i saktë i tingujve dhe përcaktimi i vendit të tyre në fjalë.

Reflektim

Hapi III

Ora përfundon me këtë aktivitet:

- GR 1 - Nxënësit e ndarë në 4 grupe punojnë detyra të ndryshme:
- GR 2 - Nxënësit vendosin X mbi figurën, që nuk i takon rreshtit.
- GR 3 - Nxënësit ngjyrosin aq katrorë sa tinguj ka fjala.
- GR 4 - Nxënësit zbulojnë rregullin dhe plotësojnë.
- GR 5 - Nxënësit ngjisin fotografitë në vendin e duhur.

Gjatë punës mësues-i/ja i udhëheq dhe i ndihmon nëse është e nevojshme. Në fund çdo përfaqësues i grupit prezanton punën e grupit të vet. Nxënësit e grupeve të tjera dëgjojnë dhe korigjojnë gabimet eventuale, nëse ka të tilla.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 21

PËRBËRJA TINGULLORE E FJALËS. TINGUJ NË FUND TË FJALËS 1

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në fund të fjalës I

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë vendin dhe renditjen e tingujve (shkronjave) në fjalë;
- të shpjegojë përbërjen tingullore të fjalës;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim, shpjegim

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacion: natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ, kulturë muzikore

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë tingullin (shkronjën) në fund të fjalës;
- identifikojnë me anë të dëgjimit fjalët, që përmbajnë tingujt të ndryshëm në fund të tyre;
- punojnë të pavarur detyrat (ushtrimet) në tekstin mësimor;
- këndojnë këngën për fëmijë "Universi".

Fjalë kyçe: tingull, shkronjë, tinguj në fund të fjalës

Mjetet e mësimi: fotografi të ndryshme, kompjuter, videoprojektor, tabelë, ngjites, teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes për disa minuta ilustrimin e paraqitur me projektor.



Më pas e përshkruajnë atë duke u ndihmuar nga pyetjet:

- Çfarë shihni në figurë?
- A i keni parë ndonjëherë këto? Nëse po, ku i keni parë?
- Çfarë dini për to?
- Çfarë është e njohur për ju?
- Çfarë është e panjohur?

– Çfarë keni dëshirë të dini për to?

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimit **“Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në fund të fjalës I”**. Mësues-i/ja sjell në klasë një enciklopedi dhe lexon informacionet, që kanë dëshirë të dinë nxënësit për këtë temë.

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurat e ngjitura në tabelë, që kanë poshtë fjalët përkatëse. Më pas i emërtojnë ato dhe gjejnë tingullin me të cilin fillon dhe mbaron fjala.

DIELLI	TOKA	HËNA	YLL	RAKETË
TELESKOP	PLANET	ASTRONAUT	UNIVERSI	

– Nxënësit gjejnë fjalë të tjera, që mbarojnë me këta tinguj: **I, A, LL, Ë, P, T**. Mësuesi u ndihmon, nëse është e nevojshme.

Reflektim

Hapi III

Nxënësit punojnë të pavarur ushtrimin e dhënë, pasi mësues-i/ja lexon dhe shpjegon kërkesën.

Ushtrim: Nxënësit lidhin me shigjetë objektet që mbarojnë me tingull të njëjtë.

Shembull: tablet – internet

Nxënësit dëgjojnë dhe këndojnë këngën për fëmijë “Universi”.

<https://youtu.be/EubKIN9-68E?si=KFSIC8QwxWgntUfc>

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 22

PËRBËRJA TINGULLORE E FJALËS . TINGUJ NË FUND TË FJALËS 2

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Përbërja tingullore e fjalës. Tinguj në fund të fjalës II

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë vendin dhe renditjen e tingujve (shkronjave) në fjalë;
- të shpjegojë përbërjen tingullore të fjalës;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim, shpjegim

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacion: natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ, kulturë muzikore

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë tingullin (shkronjën) në fund të fjalës;
- krahasojnë tingujt me të dëgjuar;
- punojnë të pavarur detyrat (ushtrimet) në tekstin mësimor.

Fjalë kyçe: tingull, shkronjë, tinguj në fund të fjalës

Mjetet e mësimi: projektor, fotografi të ndryshme, tabelë, ngjitës, teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit vëzhgojnë për disa minuta figurat e paraqitura me projektor, që poshtë kanë fjalët përkatëse. Më pas i emërtojnë ato dhe gjejnë tingullin me të cilin fillon dhe mbaron fjala.

QUKAPIKU

KALI

SHQIPONJA

XHUBLETA

ÇANTË

Realizim kuptimit

Hapi II – Punë me tekstin mësimor

Nxënësit në çifte punojnë **ushtrimin 1**, pasi mësuesi lexon dhe shpjegon kërkesën.

Ushtrimi 1 Nxënësit gjejnë tingullin me të cilin mbarojnë fjalët dhe shënojnë në katror numrin e tingujve.

Shembull:

MJEGULL

6

AKULL

4

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Ushtrim punohet në bashkëpunim mësues-nxënësi. Mësuesi shqipton fjalën dhe orienton nxënësit te tingulli (shkronja) me ngjyrë të kuqe. Nxënësit duke dëgjuar shqiptimin e mësuesit përcaktojnë vendin e tingullit **K, O, LL** në çiftet e fjalëve: **KITARË - HARK**

PIANO - ORKESTËR FYELL - LLULLË

Shembujt e tjerë të këtij ushtrimi mund të punohen edhe nga nxënësit në çifte të vëzhguar

nga mësues-i/ja. Tërhiqet vëmendja e nxënësve te shqiptimi i saktë i tingujve dhe përcaktimi i vendit të tyre në fjalë.

Reflektim

Hapi III

Nxënësit/et në mënyrë të pavarur punojnë ushtrimin, pasi mësuesi/ja lexon dhe shpjegon kërkesën.

Ushtrim. Nxënësit vizatojnë dy sende që përfundojnë me tingullin (shkronjën) **T**.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 23, 24

TINGUJ NË FILLIM, NË MES DHE NË FUND TË FJALËS 1, 2

Lënda : Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha : Gjuhë

Njësia e mësimi: Tinguj në fillim, në mes dhe në fund të fjalës 1, 2

Arritjet e të nxëniet:

Gjatë mësimi, nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë vendin dhe renditjen e tingujve (shkronjave) në fjalë;
- të shpjegojë përbërjen tingullore të fjalës;
- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;

Tipi i orës: orë për përforsim të njohurive (2 orë)

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim, analizë

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift, në grup

Korrelacioni: natyrë, njohuri shoqërie, Kultura e artit figurativ, matematikë

Aktivitetet e nxënësve:

- identifikojnë dhe shqiptojnë saktë tingullin (shkronjën) në fillim, në mes dhe në fund të fjalës;
- identifikojnë me anë të dëgjimit fjalë, që përmbajnë tinguj të njëjtë në pozicione të ndryshme;
- ndajnë fjalët në tinguj përmes lojës;
- punojnë të pavarur detyrat (ushtrimet) në tekstin mësimor.

Fjalë kyçe: tingull, shkronjë, vendi i tingujve në fjalë

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, tabelë, shkumës, laps, mjete vizatimi, hamer, projektor, kompjuter etj.

Evokim

Hapi I - Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit vëzhgojnë foton e iriqit të paraqitur me projektor. Më pas e emërtojnë dhe e përshkruajnë atë duke u ndihmuar me pyetjet:

- Çfarë shihni në figurë?
- A keni parë ndonjëherë iriq?
- Ku e keni parë?
- Çfarë dini për iriqin?
- Cili prej jush ma ndan në tinguj këtë fjalë?
- Sa kuti duhet të ngjyrosim?
- Fjala **IRIQI** ka pesë tinguj dhe ne do të ngjyrosim pesë kuti.
- Me çfarë tingulli fillon fjala iriq?
- Ku ndodhet tingulli I në këtë fjalë?

Tingulli **I** ndodhet në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.

Mësues-i/ja pyet nxënësit se kujt i fillon emri me këtë tingull të ngrejë dorën dhe organizon diskutimin duke ndrequr në bashkëpunim me nxënësit gabimet eventuale që mund të vihen re.

- Nxënësit tregojnë fjalë tjera që përmbajnë tingullin **I** dhe përcaktojnë vendin e tij në fjalë.

P.sh: **IBRIKU, MALI, ISHULLI, MAKINA** etj.

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë me tekstin mësimor

Nxënësit punojnë së bashku me mësues-in/en **ushtrimin 1**.

Ushtrimi 1 punohet në bashkëpunim mësues - nxënës. Mësuesi shqipton fjalën dhe orienton nxënësit të lidhin tingullin, që dëgjojnë në fjalë me shkronjën e duhur poshtë figurës. Nxënësit duke dëgjuar shqiptimin e mësuesit përcaktojnë vendin e tingujve **M** dhe **N** në fjalë.

Fig.MOLLA

N M R

Fig.2 ÇIZME

M R N

Fig.3 BARAZIM

R M N

Kështu vazhdohet edhe shembulli tjetër.

Nxënësit punojnë në çifte **ushtrimin 2**, pasi mësues-i/ja lexon dhe shpjegon kërkesën.

Ushtrimi 2 Nxënësit ngjisin fotografinë sipas tingullit me të cilin fillon fjala. Fotografite ndodhen në fund të librit të nxënësit.

Shembull: Tingulli **B**

BUKA, BREDHI, BANANE

Punohet **ushtrimi 3** nga nxënësit të pavarur, pasi mësues-i/ja lexon dhe shpjegon kërkesën.

Ushtrimi 3 . Nxënësit qarkojnë objektin që përmban tingullin **R, RR**.

Shembull: Tingulli **R - ZERO, RADIO, GUR**

Mësues-i/ja kontrollon dhe vlerëson saktësinë e realizimit të detyrës.

Hapi III – Punë në grupe

Nxënësit në grupe punojnë së bashku detyrat e përcaktuara nga mësimdhënësi. Mësuesi ka përgatitur disa figura, të cilat ia shpërndan secilit grup. Brenda një afati të caktuar nxënësit ngjisin figurat, ku shkronja **K** ndodhet në fillim, në mes ose në fund të fjalës.

K në fillim të fjalës	K në mes të fjalës	K në fund të fjalës

Një përfaqësues i grupit del para klasës dhe paraqet punën e grupit.

- Cili nga grupet ka punuar saktë dhe ngjitur më shumë figura?

Nxënësit e tjerë korigjojnë gabimet, nëse ka të tilla. Shpallet grupi fitues.

Reflektim

Hapi IV

Ora përfundon me këtë aktivitet:

Punohen ushtrimet nga nxënësit në mënyrë individuale, në çift apo në grup. Mësues-i/ja përzgjedh mënyrën e realizimit të detyrës.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 25, 26

TINGUJ TË PËRAFËRT DHE SHKRONJA TË NGJASHME

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Tinguj të përafërt dhe shkronja të ngjashme

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje të:

- dallojë tingujt e përafërt dhe shkronjat e ngjashme.

Tipi i orës: orë për përvetësim /përforsim të njohurive (2 ose 3 orë)

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim, shpjegim

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift

Korrelacion: Kultura e artit figurativ, kulturë muzikore, edukim fizik, natyrë dhe shoqëri

Aktivitetet e nxënësve:

- dëgjojnë shqiptimin e tingujve nga mësues-i/ja;
- shqiptojnë drejt tingujt në çifte;
- përshkruajnë lodrat e tyre;
- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- dëgjojnë, këndojnë dhe komentojnë këngën “Hapadollapa”;
- shikojnë dhe komentojnë filmin vizatimor të animuar shqiptar “Zhgarravina”;
- punojnë të pavarur detyrat në tekstin mësimor.

Fjalë kyçe: tingull të përafërt, shkronja të ngjashme

Mjetet e mësimi: kompjuter, projektor, televizion, tabelë, shkumës, teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

- Nxënësit dëgjojnë dhe këndojnë këngën “Hapadollapa” <https://youtu.be/dSHEdlx-enh4>
- Më pas zhvillohet një bisedë për këngën duke i nxitur me pyetjet: Si e përjetuat këngën? Çfarë ju kujton kjo këngë? A ju pëlqen kjo lojë? Kur dhe ku e keni luajtur për herë të fundit? Çfarë loje tjetër luani? etj.

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësuesja shkruan në tabelë titullin e mësimi “**Lodrat tona**”. Bisedon me nxënësit për lodrat e tyre të preferuara.

Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë me kujdes figurat e rreshtit të parë në faqen 51, ku kanë shkronjat : **P**, **B**, **D** dhe **T** dhe të diskutojnë me njëri - tjetrin . Më pas mësuesi së bashku me nxënësit komentojnë një nga një çdo figurë.

Fig.1 POKEMON



- Pyetjet që u drejton nxënësve: Çfarë shikoni në figurë? Ku e keni parë? A ju pëlqen ky personazh? Me cilin tingull fillon emri i tij? Shqiptohet tingulli **P** nga nxënësit në çifte.

Fig.2 BALONË



- Pyetjet që u drejton nxënësve: Çfarë shikoni në figurë? A luani ju me këtë lodër? Me cilin tingull fillon emri balonë? Shqiptohet tingulli **B** nga nxënësit në çifte.

Fig.3 DALMAT



- Pyetjet që u drejton nxënësve: Po në figurën tjetër çfarë shikoni? Kush nga ju luan me këtë lodër? Pse ju pëlqen? Me cilin tingull fillon emri dalmat? Shqiptohet tingulli **D** nga nxënësit në çifte.

Fig.4 TOMI



- Pyetjet që u drejton nxënësve: Personazh i cilit film vizatimor është Tomi? A ju pëlqen ky film vizatimor? Nëse po, pse? Kush luan me Tomin? Me cilin tingull fillon emri i tij? Shqiptohet tingulli **T** nga nxënësit në çifte.

U tërhiqet vëmendja nxënësve të shqiptimi i saktë dhe i qartë i tingujve. Mësuesi/ja ndihmon nxënësit, të cilët kanë vështirësi në shqiptimin e ndonjë tingulli.

Mësues-i/ja shkruan në tabelë shkronjat **P, B, D** dhe **T** dhe shqipton tingujt. I nxit nxënësit të dëgjojnë me vëmendje shqiptimin dhe të dallojnë/mësojnë se këta tinguj janë të përafërt. Kështu vazhdohet edhe komentimi i figurave tjera në çdo rresht.

Mësues-i /ja në çdo rresht tërheqë vëmendjen e nxënësve të tingujt e përafërt dhe shkronjat e ngjashme.

Reflektim

Hapi III

- Nxënësit shikojnë në televizion ose në videoprojektor filmin vizatimor të animuar shqiptar “Zhgaravina” (https://www.youtube.com/watch?v=EOzywpCgeE&ab_channel=be-siankozma). Komentohet së bashku me nxënës.
- Nxënësit në mënyrë të pavarur punojnë **ushtrimin**, pasi mësues-i/ja lexon dhe shpjegon kërkesën.

Ushtrim Nxënësit vizatojnë lodrën ose personazhin e tyre të preferuar në shkronjat **S, Z, SH** dhe **ZH**.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 27, 28

VENDI DHE RENDITJA E TINGUJVE - SHKRONJAVE NË FJALË

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimit: Vendi dhe renditja e tingujve - shkronjave në fjalë

Arritjet e të nxëniet:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;
- të vërejë vendin dhe renditjen e tingujve (shkronjave) në fjalë;
- të shpjegojë përbërjen tingullore të fjalës.

Tipi i orës: orë për përvetësim /përforcim të njohurive (**2 orë**)

Metodat dhe teknikat: lexim i drejtuar, bisedë, diskutim, analizë

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- dëgjojnë dhe komentojnë tekstin “Rendi i tingujve dhe shkronjave?”;
- identifikojnë vendin dhe renditjen e tingujve (shkronjave) në fjalë;
- komentojnë figurat;
- punojnë ushtrimet në tekstin mësimor.

Fjalë kyçe: tingull, shkronjë, renditje e tingujve (shkronjave)

Mjetet e mësimit: teksti mësimor, tabelë, shkumës, laps, fletore, mjete vizatimi, tablo, video projektor, kompjuter etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit vëzhgojnë, komentojnë dhe rendisin figurat e paraqitura në projektor/TV apo tabelë sipas rendit të tyre natyror. Përzgjedhja e figurave bëhet në përshtatje me njohuritë përceptuese të nxënësve. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesja.

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësuesja shkruan në tabelë titullin e mësimit **“Vendi dhe renditja e tingujve - shkronjave në fjalë”**.

Nxënësit dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit nga mësuesja dhe më pas e komentojnë atë.

Rendi i tingujve dhe shkronjave

Çdo gjë në natyrë ka rendin e vet, prandaj më parë qielli mbushet me re të zeza e pastaj fillon të bjerë shiu. Dielli lind në mëngjes e hëna fillon e del kur perëndon dielli dhe pasi errësohet, dalin

yjet. Edhe gjuha ka rregullat e saj, prandaj në çdo gjuhë tingujt e shkronjat kanë rendin e tyre. Për të krijuar fjalë, tingujt e shkronjat duhet të vendosen sipas një renditjeje të caktuar.

Hapi III – Punë me tekstin mësimor

Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë figurat në faqen 54 (ushtrimi i parë) dhe të diskutojnë me njëri – tjetrin. Më pas ata punojnë **ushtrimin 1** duke i renditur figurat sipas rendit natyror.

Punohet ushtrimi i dytë

Tërhiqet vëmendja e nxënësve tek dy figurat e para dhe çifti i fjalëve **SHOK - KOSH**.



SHOK



KOSH

Më pas përshkruajnë dy figurat e para duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë tregon figura e parë? A keni ju shok? Me cilën shkronjë fillon emri **SHOK**? Bëhet analiza tingullore e fjalës **SHOK** së bashku me nxënës. (Nxënësi dallojnë se fjala **SHOK** përbëhet nga 3 tinguj - shkronja). Nxiten për të përshkruar figurën e dytë duke u ndihmuar nga pyetjet: Çfarë tregon figura e dytë? Për çfarë e përdorim koshin? Me cilën shkronjë fillon emri **KOSH**? Bëhet analiza tingullore e fjalës **KOSH** së bashku me nxënës. (Nxënësit dallojnë se fjala **KOSH** përbëhet nga 3 tinguj - shkronja).

Mësues-i/ja u drejton nxënësve pyetjet: Çfarë kanë të njëjtë fjalët **SHOK** dhe **KOSH**? A janë shkronjat e renditura në mënyrë të njëjtë te këto dy fjalë?

Nëse nxënësit nuk arrijnë të japin përgjigje në këto pyetje, mësues-i/ja i ndihmon.

Mbi bazën e diskutimit arrihet në përfundim :

- fjalët: **SHOK** dhe **KOSH** përbëhen nga të njëjtët tinguj (shkronja).
- renditja e tingujve (shkronjave) në fjalë nuk është e njëjtë.
- **Kështu vazhdohet edhe me shembujt e tjerë.**

Mësues-i/ja mund ta paraqesë në një tablo ose me video-projektor fq. 54 të tekstit mësimor apo të shkëpusë ndonjë shembull të dhënë. Më pas vazhdon punën me tekst.

Vihet theksi se gjatë shkrimit të fjalëve duhet të kemi kujdes në renditjen si duhet të shkronjave.

Reflektim

Hapi III

- Punohen ushtrimet në tekstin mësimor.

Ushtrim. Me ndihmën e mësues-it/es nxënësit rendisin shkronjat dhe krijojnë fjalë me kup-tim.

LUMË

PESHK

VARKË

GREP

URA

Ushtrim: Me ndihmën e mësues-it/es nxënësit emërtojnë figurat dhe më pas i rendisin ato sipas alfabetit.

ARKË BUKË

CJAP

ELEFANT

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



III. LEXOJMË

MËSIMI 29

NJOHIM FJALËN SI TËRËSI E TË FOLURIT. KRIJOJMË FJALI MBI BAZËN E FIGURAVE 1

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Njohim fjalën si tërësi e të folurit. Krijojmë fjali mbi bazën e figurave I

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë fjalën si një tërësi e të folurit;
- të formojë fjali të thjeshta me gojë mbi bazën e figurave dhe ilustrimeve;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: lexim i drejtuar, bisedë, shpjegim

Format e punës: punë frontale, në çift

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ

Aktivitetet e nxënësve:

- komentojnë dyfletëshin
- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- identifikojnë fjalën si tërësi e të folurit;
- dëgjojnë dhe komentojnë tekstin “Pema e jetës”;
- krijojnë fjali mbi bazën e figurave;
- punojnë detyrën në tekstin mësimor;

Fjalë kyçe: fjala, fjali mbi bazën e figurave

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, tabelë, shkumës, laps, mjete vizatimi, hamer, projektor, kompjuter, televizio etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit/et vëzhgojnë me kujdes për disa minuta figurat e paraqitura në projektor ose televizion. Më pas të udhëhequr nga mësuesi/ja, ata dallojnë detajet në figura dhe krijojnë fjali të thjeshta me gojë mbi bazën e figurave.

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësuesja shkruan në tabelë titullin e mësimi “**Njohim fjalën si tërësi e të folurit. Krijojmë fjali mbi bazën e figurave 1**”

Nxënësit vëzhgojnë figurat e dhëna në tekstin mësimor dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit nga mësuesja:

PEMA E JETËS



Pema është simbol i jetës dhe i vazhdimësisë. Rrënjët e pemës janë të lidhura fort me të kaluarën, historinë tonë. Trungu përfaqëson forcën e cilësitë që na karakterizojnë. Ndërsa degët dhe gjetethet janë simbol i shpresave, dëshirave dhe ëndrrave tona. Edhe tingujt e shkronjat janë themelet e një gjuhe dhe me anë të tyre mund të krijojmë fjalë e fjali e mund të tregojmë ngjarje e ndodhi. Gjatë leximit mësuesja i nxit nxënësit të përgjigjen me përgjigje të plota në pyetje rreth tekstit, në mënyrë që të kuptohet më mirë përmbajtja. Nxënësit komentojnë pjesën e lexuar duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë është pema? Çfarë përfaqësojnë trugu, gjetethet dhe degët? etj.

– Mësuesi shpjegon fjalën si tërësi e të folurit.

Hapi III

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes për disa minuta figurat e dhëna në tekstin mësimor. Më pas të udhëhequr nga mësuesi, ata dallojnë detajet në figura dhe krijojnë fjali të thjeshta me gojë mbi bazën e figurave.

Reflektim

Hapi IV

Nxënësit qarkojnë fjalët sipas figurave (**MAMI, BABI, MOTRA**).

Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi/ja.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 30

NJOHIM FJALËN SI TËRËSI E TË FOLURIT. KRIJOJMË FJALI MBI BAZËN E FIGURAVE 2

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësim: Njohim fjalën si tërësi e të folurit. Krijojmë fjali mbi bazën e figurave II

Arritjet e të nxën:

Gjatë mësim nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë fjalën si një tërësi e të folurit;
- të formojë fjali të thjeshta me gojë mbi bazën e figurave;

Tipi i orës: orë për përforsim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: matematikë, natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ.

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- krijojnë fjali mbi bazën e figurave;
- “shkruajnë” së bashku me mësuesin (nxënësit diktojnë, mësuesi shkruan me shkronja të mëdha në tabelë/hamer ...);
- punojnë detyrën në tekstin mësimor;

Fjalë kyçe: fjala, fjalia mbi bazën e figurave

Mjetet e mësim: teksti mësimor, tabelë, shkumës, laps, mjete vizatimi, hamer, fotografi të ndryshme etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

- Nxënësit vëzhgojnë me kujdes për disa minuta figurat e paraqitura në videoprojektor ose televizion. Më pas të udhëhequr nga mësuesi, ata dallojnë detajet në figura dhe krijojnë fjali të thjeshta me gojë mbi bazën e figurave.

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë me tekstin mësimor

Lihen nxënësit për disa minuta të vëzhgojnë figurat e dhëna në faqen 59 dhe të diskutojnë me shokun/shoqen e bankës. Më pas nxiten të shikojnë figurën e parë dhe të thonë, se ç’sho-hin në të dhe në figurat e tjera.

Nxënësit formojnë fjali të thjeshta me gojë mbi bazën e figurave të dhëna.

Hapi III

- Mësues-i/ja u propozon nxënësve, t’i shkruajnë bashkë në tabelë ose tabak kartoni fjalitë e formuara në mënyrë gojore. Ai/ajo shkruan me shkronja të mëdha shtypi në tabak

kartoni ose tabelë fjalitë, që ia diktojnë nxënësit.

- Nxënësit që dinë, lexojnë së bashku me mësuesen fjalitë e shkruara.
- Mësues-i/ja veçon nga çdo figurë një ose dy fjalë dhe i shkruan ato, që janë të njohura nga të gjithë ose shumica e nxënësve: **FËMIJËT, PARKU, MËSUESI, NXËNËSI, DJEMTË, QENI, MACJA** etj.

Reflektim

Hapi IV

Punohet ushtrimi i dhënë në tekst fq. 60.

Ushtrim. Nxënësit bashkojnë pikat dhe krijojnë figurën (hartën e Malit të Zi). Krijojnë një fjali me të.

Mësues-i/ja shkruan me shkronja të mëdha shtypi në tabelë fjalinë, që ia diktojnë nxënësit. Nxënësit mund ta përshkruajnë fjalinë.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 31

“LEXOJMË” SË BASHKU

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: “Lexojmë” së bashku

Arritjet e të nxënit :

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë porositë figurative dhe të sqarojë përmbajtjen e tyre.

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim, shpjegim

Format e punës: punë frontale, individuale, në grup

Korrelacioni: kulturë muzikore, natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ, matematikë

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- komentojnë figurat ;
- punojnë në grupe;
- punojnë detyrën në tekstin mësimor.


Fjalë kyçe: tabelat, mbishkrimet

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, tabelë, shkurtesë, karton, letra me ngjyra, ngjitës, gërshërë, laps, mjete vizatimi, hamer, fotografi të ndryshme, CD, magnetofon, kompjuter etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxiten nxënësit të mendojnë rreth pyetjes: Pse është i rëndësishëm semafori? Mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë.



Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën “Semafori”. Më pas e komentojnë atë.

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi “Lexojmë” së bashku .

Lihen nxënësit për disa minuta të shikojnë fotografite në faqen 61 dhe të diskutojnë me shokun/shoqen. Emërtohen figurat e dhëna duke tërhequr vëmendjen e nxënësve te kuptimi dhe rëndësia e tyre. Nxënësit komentojnë figurat duke dhënë përgjigje të plota në pyet-

jet: Çfarë tregon figura e parë? Ku e keni parë? A keni qenë ndonjëherë në aeroport? Pse keni shkuar atje? Çfarë tregon figura e dytë? etj.



AEROPORT



RRUGË PËR BIÇIKLETA

Ndiquet e njëjta veprimtari me figurat e tjera.

Reflektim

Nxënësit e ndarë në grupe punojnë së bashku detyrat e përcaktuara:

- Nxënësit përmes vizatimit tregojnë tabela të tjera, që shohin gjatë rrugës për në shkollë. Bisedë rreth tyre.
- Nxënësit punojnë në grupe ndërtimin e semaforit me mjetet që kanë sjellë në klasë.

Mësuesja udhëzon nxënësit dhe i ndihmon ata hap pas hapi. Në fund çdo përfaqësues i grupit prezanton punën e grupit të vet.

Punojnë detyrën e dhënë në tekstin mësimor. Vizatojnë dy tabela.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 32

“LEXOJMË” SË BASHKU

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: “Lexojmë” së bashku

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë porosinë figurative dhe të sqarojë përmbajtjen e tyre.

Tipi i orës: orë për përforsim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim

Format e punës: punë frontale, individuale, në grup

Korrelacioni: natyrë, kulturë muzikore, njohuri shoqërie, Kultura e artit figurativ, matematikë

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- komentojnë figurat ;
- punojnë në grupe;

Fjalë kyçe: tabelat, mbishkrimet

Mjetet e mësimi: revista, letra me ngjyra, ngjites, gërshtë, laps, mjete vizatimi, hamer, fotografi të ndryshme

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Mësues-i/ja mund të bëjë një nga aktivitetet e mëposhtme:

- Shëtitje e shkurtër me nxënësit në rrugën pranë shkollës (nëse shkolla është në një zonë urbane). Vëzhgohen tabelat dhe shenjat e qarkullimit rrugor dhe diskutohet rreth tyre.
- Vizitë shitore me të afërt. Nxënësit vëzhgojnë produktet ushqimore/produktet higjienike dhe diskutohet rreth tyre.
- Viziton me nxënësit ndërtesën e shkollës dhe u tregon ambientet e ndryshme shkollore, në dyert e të cilave është shkruar se ç’funksione kanë: **SALLA E MËSUESVE, DREJTORIA, SEKRETARIA, SALLA E FIZKULTURËS, BIBLIOTEKA...**;

Realizim kuptimi

Hapi II

Nxënësit e ndarë në grupe punojnë së bashku me materiale, që kanë sjellë në klasë. Nxënësit presin dhe ngjisin fotografitë që lidhen me temën e dhënë.

Gr.1- Tabelat dhe shenjat e qarkullimit rrugor.

Gr.2 - Vendet turistike dhe kulturore në vendlindje.

Gr.3 - Shitoret, lokalet dhe restorantet.

Gr.4 - Vizitënë bibliotekë e shkollës dhe fotografim i titujve të librave me ilustrime.

Mësuesja udhëzon nxënësit dhe i ndihmon ata hap pas hapi.

Reflektim

Hapi III

Prezantojnë punën e tyre. Vlerësim i nxënësve.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____



MËSIMI 33

KRIJOJMË TEKSTE SIPAS FIGURAVE

Lënda : Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Krijojmë tekste sipas figurave

Arritjet e të nxëniti:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të formojë fjali të thjeshta me gojë mbi bazën e figurave dhe ilustrimeve;
- të “lexojë” në bazë të ilustrimeve (librat me figura, librat me ilustrime);

Tipi i orës: orë për përvetësim/përforcim të njohurive (2 orë)

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: natyrë dhe shoqëri, kulturë muzikore, Kultura e artit figurativ

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- krijojnë fjali mbi bazën e figurave;
- krijojnë tekste sipas figurave;
- marrin pjesë në leximin e përbashkët (mësimdhënësi dhe nxënësit lexojnë të gjithë së bashku);
- demostrojnë në grupe mbjelljen e farës.

Fjalë kyçe: tekste sipas figurave

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, fara, dhe, ujë, kovë, fotografi të ndryshme, CD, magnetofon, kompjuter, TV etj.

Evokim

Hapi I- Veprimtari paraprake


Nxënësit vëzhgojnë dhe komentojnë figurën e bimës të paraqitur në TV duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë shihni në figurë? Cilat janë pjesët e bimës? Çfarë i nevojitet bimës për të jetuar?etj

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësuesja shkruan në tabelë titullin e mësimi **“Krijojmë tekste sipas figurave”** .

Nxënësit lihen për disa minuta të vëzhgojnë figurat në tekstin mësimor dhe të diskutojnë me shokët. Për çdo figurë nxënësit krijojnë nga një fjali. Nxitet mendimi i nxënësve duke improvizuar një histori të shkurtër mbi bazën e figurave:



Bimët

Bimët kanë një cikël jetësor, ashtu si njerëzit dhe kafshët e tjera. Cikli jetësor i bimës përshkruan fazat nëpër të cilat kalon bima nga fillimi i jetës së saj deri në fund. Cikli jetësor i një bime fillon me një farë. Brenda shtresës së farës është një embrion, i cili do të bëhet bimë e re. Farërat kanë nevojë për katër gjëra për t'u rritur: oksigjen, lagështi, rrezet e diellit dhe temperaturën e duhur. Kur të plotësohen kushtet e duhura për farën, ajo do të fillojë të mbijë. Pastaj rritet dhe krijon një fidan. Fidani rritet dhe bima fillon të lulëzojë. Dalëngadalë lulet krijojnë frytin. E kështu cikli përsëritet.

- Qartë dhe me zë, bashkë me nxënës, mësuesi lexon tekstin joletrar të kthyer nga figura në tekst .
- Nxënësit dëgjojnë, këndojnë, komentojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë “Sa i dua lulet”.

Nxënësit të pavarur punojnë **ushtrimin e dhënë**, pasi mësuesi shpjegon kërkesën.

Reflektim

Hapi III

Nxënësit “lexojnë” në mënyrë të pavarur tregimin sipas figurave. Ata që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësuesi.

Hapi IV

Demonstrohet në grupe mbjellja e farës.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim: _____



MËSIMI 34, 35

KRIJONI HISTORINË TUAJ NË BAZË TË FIGURAVE. PASIONET E MIA.

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Krijoni historinë tuaj në bazë të figurave. Pasionet e mia

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të krijojë vetë tekste figurative (vizaton ose presin nga revistat fotografi që lidhen me temën për të cilën flasin).

Tipi i orës: orë për përvetësim/përforcim të njohurive (2 orë)

Metodat dhe teknikat: bisedë, diskutim, demonstrim

Format e punës : punë frontale, individuale

Korrelacioni: kulturë muzikore, natyrë dhe shoqëri, Kultura e artit figurativ, edukim fizik

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- këndojnë dhe komentojnë këngën “Jam piktores”;
- krijojnë një tekst figurativ për pasionin e tyre: vizatojnë ose presin nga revistat fotografi që lidhen me temën;
- prezantojnë para klasës punën e tyre;

Fjalë kyçe: pasionet, tekste figurative

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, tabelë, fotografi të ndryshme, ngjitës, gërvshërë, laps, mjete vizatimi, CD, magnetofon, kompjuter etj.

Evokim

Hapi I- Veprimtari paraprake

- Nxitet mendimi i nxënësve duke iu drejtuar atyre pyetjen: Cili është pasioni juaj ?



Mësues-i/ja i kushton rëndësi të shprehurit qartë dhe me fjali të plota nga nxënësit.

Realizim kuptimi

Hapi II - Informacion i ri

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e mësimi “**Krijoni historinë tuaj në bazë të figurave. Pasionet e mia**”.

Lihen nxënësit për disa minuta të shikojnë fotografisë dhe të diskutojnë me shokun/shoqen për pasionet e djemve dhe vajzave në figura. Më pas nxit bisedën duke u drejtuar pyetjet: Kë shikoni në fotografinë e parë? Cili është pasioni i vajzës? Cilët/Cilës nga ju i pëlqen ky pasion? Pse? Kë shikoni në fotografinë e dytë? A ju pëlqen ju ky pasion? Pse?

Vazhdohet e njëjta veprimtari me figurat e tjera.

Mësues-i/ja i kushton rëndësi të shprehurit qartë dhe me fjali të plota nga nxënësit.

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë, komentojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë *"Jam piktores"* (<https://youtube.com/watch?v=OUUucvZflo0&feature=shared>).

Reflektim

Hapi III - Nxënësit punojnë detyrën në tekst: Vizatoni ose ngjitni fotografi dhe më pas krijoni një tekst për temën "Pasioni im".

Mësuesi vëzhgon punën e nxënësve bankë më bankë dhe ndihmon, nëse është e nevojshme. Në përfundim të punës nxënësit prezantojnë atë para klasës. "Lexojnë" tekstin me figura që kanë krijuar.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



IV. SHKRUAJMË

MËSIMI 36, 37

ELEMENTET E SHKRONJAVE

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Elementet e shkronjave

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar.

Tipi i orës: orë për përvetësim/përforcim të njohurive (2 orë)

Metodat dhe teknikat: bashkëbisedim, demonstrim.

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: Kultura e artit figurativ, natyrë dhe shoqëri, matematikë

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- shkruajnë individualisht elementet e shkronjës (ushtrojnë vëmendjen pamore, motorikën e dorës - teknikën e kapjes së lapsit);
- identifikojnë lidhjen tingull - shkronjë përmes ushtrimeve;

Fjalë kyçe: elementet e shkronjave, tingull - shkronjë

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, tabelë, fotografi të ndryshme, ngjites, gërshërë, laps, mjete vizatimi, fletore, TV, projektor etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit vëzhgojnë fotografitë e paraqitura në TV ose projektor (aeroplani, lepuri, gjarpri, ariu, topi) dhe i komentojnë ato. Disa nxënës imitojnë lëvizjen e tyre duke lëvizur dorën në ajër, kurse disa të tjerë demonstrojnë në tabelë lëvizjen e tyre. Më pas shqiptojnë fjalët dhe tregojnë me cilin tingull fillojnë: AEROPLANI → A, LEPURI → L etj.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësues-i/ja shkruan në tabelë titullin e mësimi **“Elementet e shkronjave”**.

Lihen nxënësit për disa minuta të vëzhgojnë ilustrimet në tekst dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas u tërhiqet vëmendja nxënësve tek elementet e shkrimit. Ushtrohen nxënësit të imitojnë shkrimin e tyre duke lëvizur dorën në ajër.

Shembull: imitohet lëvizja e tullumbaces, fluturës dhe aeroplanit.

- Në mënyrë individuale nxënësit kalojnë lapsin mbi vijat e ndërprera dhe demonstrojnë lëvizjen e fluturës, bletës, aeroplanit etj. Punojnë dhe ushtrojnë motorikën e dorës. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqet ose mësues-i/ja .

Hapi III

- Nxënësit në çifte punojnë ushtrimin tjetër, pasi mësues-i/ja shpjegon kërkesën.

Ushtrimi. Shqipto fjalën dhe plotëso shkronjën që mungon.

ARI

MAMI

IRIQ

URA

Reflektim

Hapi IV

- Nxënësit praktikojnë shkrimin e vijave të ngjashme me ato, që punuan në libër ose mund të shkruajnë vija të drejta, vertikale, horizontale e të pjerrëta.
- Mësues-i/ja i udhëzon nxënësit se gjatë shkrimit duhet të shkruajnë nga lart poshtë dhe nga e majta në të djathtë.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 38

FORMOJMË DHE RENDISIM SHKRONJA

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Formojmë dhe rendisim shkronja

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;
- të vërejë vendin dhe renditjen e tingujve (shkronjave) në fjalë

Tipi i orës: orë për përforsim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, demonstrim, truri i galerisë

Format e punës: punë frontale, në grup

Korrelacioni: Kultura e artit figurativ, natyrë dhe shoqëri

Aktivitetet e nxënësve:

- formojnë shkronja me materiale të ndryshme;
- rendisin shkronjat sipas rendit të duhur;
- punojnë në grupe;
- prezantojnë punën e vet dhe vlerësojnë punën e grupeve të tjera;

Fjalë kyçe: shkronja

Mjetet e mësimi: materiale të ndryshme, tabak letre, ngjitës, teksti mësimor, projektor etj.

Evokim

Hapi I- Veprimtari paraprake


Mësues-i/ja me projektor prezanton punimin e shkronjave me materiale të ndryshme. Kommentohen ato me nxënësit.

Realizim kuptimi

Hapi II – Punë me tekstin mësimor

Nxënësit komentojnë fotot e paraqitura në faqen 70.

Më pas punojnë **ushtrimin** duke renditur shkronjat sipas rendit të duhur dhe krijojnë fjalë. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen.



Hapi III

Nxënësit e ndarë në grupe punojnë nga dy ose tri shkronja me materiale të ndryshme, që kanë sjellë në klasë.

Gr.1- Punojnë shkronjat me pulla me ngjyra të ndryshme.

Gr.2 - Punojnë shkronjat me plastelinë.

Gr.3 - Punojnë shkronjat me kube.

Gr.4 - Punojnë shkronjat me makarona ose oriz.

Gr.5- Punojnë shkronjat me fleta me ngjitje.

Mësues-i/ja udhëzon nxënësit dhe i ndihmon, nëse kanë vështirësi .

Reflektim

Hapi IV – Truri i galerisë

Në përfundim të punës, nxënësit prezantojnë punën e tyre. Ngjisin punimet në muret e klasës, të përcaktuara për galeri. Nxënësit shikojnë punën e njëri - tjetrit.

Vlerësim: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 39, 40

PROVOJMË TË SHKRUAJMË

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Provojmë të shkruajmë

Arritjet e të nxëniti:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;
- të krahasojë fjalët në bazë të numrit të tingujve;

Tipi i orës: orë për përvetësim/përforcim të njohurive (**2 orë**)

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, bisedë, analizë

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: Kultura e artit figurativ, natyrë etj.

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimet e tyre;
- përshkruajnë shkronja/fjalë;
- krahasojnë fjalët në bazë të numrit të tingujve;
- vlerësojnë në mënyrë kritike qëndrimin jo të drejtë gjatë të lexuarit/shkruarit.

Fjalë kyçe: shkronja, fjalë

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi, tabelë, fletore etj.

Evokim

Hapi I – Diskutim për njohuritë paraprake



Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë titullin e mësimi **“Provojmë të shkruajmë”**.

Nxënësit lihen për disa minuta të shikojnë fotografitë në tekstin mësimor dhe të diskutojnë me njëri-tjetrin. Më pas emërtojnë fotografitë dhe në mënyrë individuale kalojnë lapsin mbi pikat e shkruajnë shkronjat/fjalët. Ngjyrosin shkronjat.

Mësuesi vëzhgon punën e secilit nxënës bankë më bankë. Ndhmon nxënësit, që kanë vështirësi, nëse ka të tillë. Më pas lexohen fjalët (nga mësuesi dhe ndonjë nxënës, që di të lexojë) dhe krahasohen ato në bazë të numrit të tingujve.

Hapi III

Nxënësit në çifte punojnë **ushtrimin e parë**. Shënojnë me X qëndrimin jo të duhur në fotot e dhëna.

Shembull:



- Demonstrim i qëndrimit në bankë nga të gjithë nxënësit.

Mësuesi shpjegon rëndësinë e qëndrimit të drejtë në bankë gjatë të shkruarit/lexuarit.

Reflektim

Hapi IV

Nxënësit në mënyrë individuale punojnë **ushtrimet**. Vizatojnë qëndrimin e duhur në bankë.

Nxënësit përshkruajnë në fletore fjalët, që shkruan mësuesi në tabelë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 41

UNË SHKRUAJ

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Unë shkruaj

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të njohë shkronjën si shenjë për një tingull të caktuar;
- të krahasojë fjalët në bazë të numrit të tingujve;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, demonstrim

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: Kultura e artit figurativ, natyrë dhe shoqëri etj.

Aktivitetet e nxënësve:

- përshkruajnë/shkruajnë vetë emrin e vet;
- krahasojnë fjalët në bazë të numrit të tingujve;
- punojnë ushtrimet në tekstin mësimor;

Fjalë kyçe: shkronja, fjalë

Mjetet e mësimi: teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi, tabelë, fletore etj.

Evokim

Hapi I - Prezantohen nxënësit me rrallë dhe secili bën ndarjen e emrit të vet në tinguj.

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

- Mësues-i/ja shkruan titullin e temës në tabelë **“Unë shkruaj”**.

Mësues-i/ja ka përgatitur nga një fletë me emrin e secilit nxënësi të shkruar me shkronja kapitale dhe u jep si detyrë që ta kopjojnë mëposhtë. Mund ta ngjyrosin emrin e tyre dhe t'i presin me gërshtë shkronjat për t'i ngjitur më pas tek dollapi i tyre, dera e dhomës, koka e krevatit etj.

* Nxënësit hapin tekstin mësimor dhe njihen me bashkëmoshataren e tyre Dina.

Reflektim

Hapi III

- Nxënësit të pavarur punojnë ushtrimin në fq. 74, pasi mësues-i/ja shpjegon kërkesën.

Ushtrimi. Bashkojnë pikat dhe shkruajnë emrin e objektit. Në fund e ngjyrosin.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



MËSIMI 42, 43

DALLOJMË SHKRONJAT E NJËJTA DHE TË NDRYSHME NË FJALËT E SHKRUARA

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Dallojmë shkronjat e njëjta dhe të ndryshme në fjalët e shkruara

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë shkronjat e njëjta dhe të ndryshme në fjalët e shkruara;

Tipi i orës: orë për përvetësim/përforcim njohurish (2 orë)

Metodat dhe teknikat: vëzhgo - diskuto, bisedë,

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift

Korrelacioni: Kultura e artit figurativ, natyrë dhe shoqëri etj.

Aktivitetet e nxënësve:

- përshkruajnë fotografitë;
- identifikojnë shkronjat e njëjta dhe të ndryshme në fjalët e shkruara;
- punojnë ushtrimet në tekstin mësimor.

Fjalë kyçe: shkronja të njëjta, shkronja të ndryshme

Mjetet e mësimi: projektor, tabak letre, teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi, tabelë etj.

Evokim

Hapi I – Diskutim për njohuritë paraprake

- Nxënësit vëzhgojnë fotografinë e çantës të paraqitur në TV ose projektor dhe e përshkruajnë duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë shikoni në figurë? Pse ju duhet çanta? Çfarë vendosni në çantë? Me cilin tingull fillon emri çantë? etj.

Hapi II

- Nxiten nxënësit të emërtojnë figurat që ndodhen në faqe 76 (ushtrimi i parë): **ÇANTË, FLETORË, GOMË, GËRSHËRË, VIZORË, LIBËR**. Mësues-i/ja lexon fjalët poshtë figurave dhe tërheq vëmendja e nxënësve të shkronjat me ngjyrë të njëjtë në fjalët e dhëna. Nxënësit krahasojnë dhe qarkojnë shkronjat e njëjta në të gjitha fjalët.

Realizim kuptimi

Hapi III – Punë me tekstin mësimor

- Nxënësit punojnë ushtrimin e dytë së bashku me mësues-in/en. Mësues-i/ja shkruan në tabelë fjalët (emrat e sendeve) dhe nxënësit i kopjojnë ato. Më pas ngjyrosin sendet.

Pasi është plotësuar ushtrimi i dytë, në mënyrë të pavarur nxënësit plotësojnë ushtrimin e tretë, faqe 77.

Ushtrime. Qarkojnë fjalën e duhur sipas figurës. Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga

shokët/shoqja ose mësuesi/ja.

Punojnë **ushtrime** me ndihmën e mësuesit/es (gjejnë dhe qarkojnë emrat e kafshëve dhe më pas i shkruajnë ata sipas modelit).

Reflektim

Hapi IV

Nxënësit në çifte punojnë **ushtrime**. Pasi mësues-i/ja shpjegon kërkesat.

Ushtrim: Ndiqni fillin dhe kopjoni fjalët në tabelë: PANTALLONA, BLUZË etj.



Ushtrimi: Ngjyrosin figurën e duhur në rresht, pasi mësues-i/ja lexon fjalët (nëse nxënësit nuk dinë t'i lexojnë në mënyrë globale). Nxënësit që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/shoqja ose mësues-i/ja.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____



V. DËGJOJMË DHE KOMUNIKOJMË

MËSIMI 44, 45

RUAJMË NATYRËN

Lënda : Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimi: Ruajmë natyrën

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë dhe veçojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të krahasojë të dhënat nga teksti me të dhënat nga përvoja e vet për të njëjtën temë;

Tipi i orës: orë për përvetësim/përforsim të njohurive **2 orë**

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, lexim i drejtuar, truri i galerisë

Format e punës: punë frontale, individuale

Korrelacioni: kulturë muzikore, Kultura e artit figurativ, natyrë dhe shoqëri etj.

Aktivitetet e nxënësve:

- komentojnë dyfletëshin
- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- dëgjojnë me vëmendje tekstin jolettrar dhe e komentojnë atë;
- rrëfejnë mbi përvojat personale në lidhje me të njëjtën temë;
- punojnë detyrat në tekstin mësimor;


Fjalë kyçe: natyra

Mjetet e mësimi: kompjuter, cd, projektor, tabak letre, teksti, laps, gomë, mjete vizatimi, tabelë, foto etj.

Evokim

Hapi I – Diskutim për njohuritë paraprake

- Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe mësuesja plotëson skemën.



Hapi II

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë **“Mos e dëmto natyrën”**- Eda Kaliqi dhe Anida Cana.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë temën e mësimi **“Ruajmë natyrën”**.

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurën dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit nga më-

suesja.



Ruajmë natyrën

Shpesh dëgjojmë shprehjen “të jemi të gjelbër”. Po cili është kuptimi i saj? Pse përmendet ngjyra e gjelbër? E gjelbra është më shumë se një ngjyrë, ajo nënkupton mbrojtjen e mjedisit ku jetojmë. Bimët janë të gjelbra dhe pa to toka nuk do të ekzistonte. Çfarë mund të bësh ti për të qenë i gjelbër? Ja disa hapa:

- Zvogëlo sasinë e gjërave që përdor ose që i hedh në kosh.
- Ripërdori gjërat kur ke mundësi.
- Shijoj natyrën. Ec në pyll, mbill një pemë etj.

Nxënësit komentojnë pjesën duke u ndihmuar me pyetjet: Cilën shprehje dëgjojmë më shpesh? Çfarë simbolizon ngjyra e gjelbër? Si mund ta mbron natyrën? etj.

Mësuesja shpjegon rëndësinë e ruajtjes së natyrës, për një jetë të shëndetshme duke sjellë shembuj konkretë.

Hapi IV – Punë me tekstin mësimor

- Punohet **ushtrimi**. Komentojnë fotografitë së bashku me nxënës. Për çdo fotografi nxirret nga një porosi.

Reflektim - Truri i galerisë

Punohet **ushtrimi**. Nxënësit të pavarur paraqesin nëpërmjet vizatimeve kujdesin e tyre për natyrën. Në përfundim të punës punimet e tyre i vendosin në këndin e klasës. Nxënësit shikojnë dhe vlerësojnë punën e njëri-tjetrit.

Hapi V

Punë me fjalët e reja që kanë mësuar – përbërja e tyre tingullore.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësuesit për realizim _____

Shënim: Orë tjetër për këtë temë:

1. Pastrimi i oborrit të shkollës.

2. Mbjellja e fidaneve ose luleve në oborrin e shkollës.

Krijim i një teksti me gojë për veprimtarinë e bërë.



DËGJOJMË DHE KOMUNIKOJMË

MËSIMI 46, 47

Lënda : Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimit: Pranvera

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë dhe veçojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të krahasojë të dhënat nga teksti me të dhënat nga përvoja e vet për të njëjtën temë;

Tipi i orës: orë për përvetësim/përforcim të njohurive **2 orë**

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, bisedë, lexim i drejtuar,

Format e punës: punë frontale, individuale, në grup, në çift

Korrelacioni: kulturë muzikore, Kultura e artit figurativ, natyrë dhe shoqëri etj.

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- dëgjojnë dhe këndojnë këngën “Pranvera”;
- dëgjojnë me vëmendje tekstin jolettrar dhe e komentojnë atë;
- punojnë në çifte dhe grupe detyrat e caktuara nga mësuesi;

Fjalë kyçe: pranvera

Mjetet e mësimit: kompjuter, cd, projektor, tabak letre, teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi, tabelë, foto etj.

Evokim

Hapi I – Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit tregojnë çfarë dinë për stinën e pranverës. Mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë nga mësuesja.



Hapi II

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën për fëmijë “Pranvera”- Era Elshani dhe Lina Neziri.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësuesja shkruan në tabelë temën e mësimit “Pranvera”.

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes ilustrimin në fillim të faqes 84 dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit nga mësuesja.



Pranvera

Pranvera është stina e parë e vitit. Me ardhjen e pranverës natyra gjallërohet, moti bëhet më i ngrohtë, dita është më e gjatë. Cilat janë shenjat e pranverës?

Gjatë dimrit, degët e pemëve janë të zhveshura, ndërsa tani ato kanë sytha të cilat do të bëhen gjethe ose lule. Pranvera ka ditë me diell, por edhe me shi. Shiu është i domosdoshëm për bimët që ato të rriten. Pranvera është koha më e mirë për të mbjellë në kopsht. Mbillni fara dhe ujitini ato çdo ditë. Shikoni kopshtin tuaj të rritet.

Nxënësit komentojnë pjesën duke u ndihmuar me pyetjet: Cila është stina e parë e vitit? Cilat janë karakteristikat e pranverës? etj.

Hapi IV – Punë me tekstin mësimor

*Punohet ushtrimi i parë. Nxënësit vëzhgojnë, krahasojnë dhe komentojnë figurat e dhëna së bashku me mësuesin.

Reflektim

Hapi V

Nxënësit në çifte punojnë ushtrimin e dytë. Ata që kanë vështirësi ndihmohen nga shokët/ shoqet ose mësuesi.



Nxënësit e ndarë në grupe ngjisin fotografitë në tabak letre, sipas kërkesës së detyrës të dhënë nga mësuesja

Gr.1 – Moti në pranverë;

Gr.2 – Pamja e natyrës;

Gr.3 – Punët e bujqve;

Gr.4 – Aktivitetet e fëmijëve.

Në përfundim të punës, çdo përfaqësues paraqet punën e grupit të vet. Nxënësit e tjerë vëzhgojnë, vlerësojnë dhe korigjojnë punën e njëri - tjetrit.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____

Shënim: Orë tjetër për këtë temë mund të realizohet përmes mbjelljes së luleve në oborrin e shkollës. Krijim i një teksti me gojë për veprimtarinë e bërë.



DËGJOJMË DHE KOMUNIKOJMË

MËSIMI 48, 49

KUJDESI PËR DHËMBËT

Lënda : Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimit: Kujdesi për dhëmbët

Arritjet e të nxënësve:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë dhe veçojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të krahasojë të dhënat nga teksti me të dhënat nga përvoja e vet për të njëjtën temë;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: bisedë, lexim i drejtuar, demonstrim

Format e punës: punë frontale, individuale, në grup

Korrelacioni: kulturë muzikore, Kultura e artit figurativ, natyrë dhe shoqëri etj.

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- dëgjojnë me vëmendje tekstin joletrar dhe e komentojnë atë;
- demonstrojnë larjen e dhëmbëve;
- punojnë në grupe.

Fjalë kyçe: dhëmbi, këshilla, dentisti

Mjetet e mësimit: kompjuter, cd, projektor, tabak letre, teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi, tabelë, foto etj.

Evokim

Hapi I – Veprimtari paraprake

Nxënësit dëgjojnë, këndojnë dhe improvizojnë me lëvizje e shprehi këngën “Dhëmbë të shëndoshë, fëmijë të lumtur”.

Hapi II


Komentojnë së bashku me mësuesen fotografitë e paraqitura në TV ose projektor - kujdesi për dhëmbët.

Realizim kuptimi

Hapi III – Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë temën e mësimit **“Kujdesi për dhëmbët”**.

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurën dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit nga mësuesja.



Kujdesi për dhëmbët

Në kohët e lashta njerëzit përdornin bimë të ndryshme për t'u kujdesur për dhëmbët. Sot kemi mjete dhe mjekë që e kanë profesion. Ata quhen dentistë. Dentistët na ndihmojnë që të mjekojmë dhëmbët dhe t'i parandalojmë sëmundjet që lidhen me to. Larja e dhëmbëve të paktën dy herë në ditë mund të parandalojë prishjen e dhëmbëve. Megjithatë vizitat duhen bërë tek dentisti të paktën një herë në vit.

Nxënësit komentojnë pjesën duke u ndihmuar me pyetjet: Çfarë përdornin njerëzit në kohët e lashta për t'u kujdesur për dhëmbët? Po sot? Si quhen mjekët e dhëmbëve? Çfarë na ndihmojnë ata? etj.

- Komentohen figurat e dhëna në tekstin mësimor. Për çdo figurë nxënësit nxjerrin nga një porosi.

Hapi IV

- Mësuesja shpjegon rëndësisë e larjes së dhëmbëve dhe kujdesit për ta, për një jetë të shëndetshme.
- Demonstrim i larjes së dhëmbëve nga nxënësit.
- Punohet **ushtrimi** nga nxënësit të pavarur, pasi mësuesja shpjegon kërkesën. Paraqesin me vizatim tri porosi për kujdesin e dhëmbëve.

Reflektim

Hapi V

Nxënësit e ndarë në grupe ngjisin fotografitë në tabak letre, sipas kërkesës së detyrës të dhënë nga mësuesja.

Gr.1 – Dhëmbë të shëndetshëm

Gr.2 – Dhëmbë jo të shëndetshëm

Në përfundim të punës, çdo përfaqësues paraqet punën e grupit të vet. Nxënësit e tjerë vëzhgojnë, vlerësojnë dhe korrigjojnë punën e njëri-tjetrit.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____

Shënim: Orë tjetër për këtë temë:

1. Mysafirë në klasë: dentisti i fëmijëve.

2. Vizitë në klinikën dentare për fëmijë.

Mbresat nga takimi me dentistin, nxënësit i shprehin në mënyra të ndryshme (me gojë, nëpërmjet vizatimit etj.).



MËSIMI 50

TELEFONI

Lënda : Gjuhë shqipe dhe letërsi

Fusha: Gjuhë

Njësia e mësimit: Telefoni

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të vërejë dhe veçojë të dhënat më të rëndësishme në tekst;
- të krahasojë të dhënat nga teksti me të dhënat nga përvoja e vet për të njëjtën temë;

Tipi i orës: orë për përvetësim të njohurive

Metodat dhe teknikat: stuhi mendimesh, lexim i drejtuar, diskutim, demonstrim

Format e punës: punë frontale, individuale, në çift

Korrelacioni: Kultura e artit figurativ, natyrë dhe shoqëri etj.

Aktivitetet e nxënësve:

- shprehin lirshëm mendimin e tyre;
- dëgjojnë me vëmendje tekstin jolettrar dhe e komentojnë atë;
- punojnë në çifte;


Fjalë kyçe: mjetet e komunikimit, telefoni

Mjetet e mësimit: kompjuter, projektor, tabak letre, teksti mësimor, laps, gomë, mjete vizatimi, tabelë, foto etj.

Evokim

Hapi I – Diskutim për njohuritë paraprake

Nxënësit shprehin lirshëm mendimet e tyre dhe mësuesi plotëson skemën.



- Diskutojnë me njëri - tjetrin: Cilin mjet komunikimi përdorin më shpesh? Pse?

Realizim kuptimi

Hapi II – Informacion i ri

Mësuesi shkruan në tabelë temën e mësimit **“Telefoni”**.

Nxënësit vëzhgojnë me kujdes figurat dhe dëgjojnë me vëmendje leximin e tekstit nga mësuesja.



Telefoni

Njerëzit i ndajnë informacionet me njëri-tjetrin përmes komunikimit. Të gjitha format e komunikimit kanë një gjë të përbashkët: dërgimin dhe marrjen e një mesazhi.

Për të komunikuar mund të përdoren edhe mjete elektronike, si telefoni, televizori, radioja, kompjuteri etj. Në fillim telefoni e transmetonte mesazhin vetëm nëpërmjet telave, ndërsa sot kemi telefon celular që e realizojnë transmetimin në mënyrë elektronike.

Nxënësit komentojnë pjesën duke u ndihmuar me pyetjet: Cilat mjete elektronike përdoren për të komunikuar? Si e transmetonte mesazhin telefoni dikur? Si e transmeton sot? etj.

Hapi III

Mësuesi nëpërmjet fotove të paraqitura me projektor shpjegon **anët pozitive** dhe **negative** të përdorimit të telefonit.

Reflektim

Hapi IV

Demonstrim i bisedës në telefon nga nxënësit në çifte.

Punohet **ushtrimi**. Nxënësit në çifte krijojnë me mjete të paraqitura në fotografi telefonin.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për njohuritë e fituara gjatë orës.

Vërejtjet e mësues-it/es për realizim : _____

TEKSTET:

I. FLASIM

Një mëngjes i veçantë

Fjala “Mirëmëngjesi!” është një përshëndetje që e përdorim gjatë mëngjesit për t’u përshëndetur me një person. Me këtë përshëndetje shprehim dëshirën për të filluar një bisedë me dikë tjetër. Përshëndetjen “Mirëmëngjesi!” në ditën e parë të shkollës dhe takimin me mësuesen do ta mbani mend gjatë.

Familja ime dhe përshëndetjet

A duhet të përdoren përshëndetjet në familje? Patjetër, edhe brenda familjes duhet të jemi të kujdesshëm dhe t’i përdorim përshëndetjet. Sapo të zgjohemi, përshëndesim me fjalën “Mirëmëngjesi!” gjyshërit, prindërit, si dhe motrat a vëllezërit. Kur largohemi për në shkollë përshëndesim “Ditën e mirë” dhe në darkë “Mirëmbrema!” apo “Natën e mirë!”. Këto rregulla i mësojmë në fillim në familje e pastaj edhe në shkollë. Ato janë pjesë e domosdoshme e komunikimit në shoqëri.

II. DËGJOJMË DHE DALLOJMË TINGUJT E SHKRONJAT

Tingujt dhe shkronjat

Tingujt mund të përftohen në natyrë, si tingulli që bëjnë valët e detit apo era kur fryn. Kemi edhe tinguj që përftohen nga një instrument muzikor, si tingulli që lëshon daulla, pianoja etj. Po tinguj kemi edhe në gjuhë. Ata krijohen gjatë të folurit. Gjuha e folur përbëhet nga tinguj, ndërsa gjuha e shkruar nga shkronjat. Alfabeti i gjuhës shqipe ka 36 shkronja.

ROSAKU

NJË ROSAK TOPOLAK

PO NA ISHTE DHE DINAK

NGJYRA – NGJYRA I NDRIN FYTYRA,

PO PËRTONTE PËR DETYRA.

MOR ROSAK BUKUROSH

HAJDE BËHU DHE TRIMOSH

BËJ MËSIMET MOS PËRTO

DËGJO PRINDËRIT E LEXO.

(vetëkrijim - M. P.)

Rosat dhe patat

Rosat dhe patat mbahen kryesisht si shpend uji. Ka lloje të ndryshme të patave dhe rosave. Ata mund të jenë shpend të egjër ose edhe të butë. Prej shumë shekujsh patat dhe rosat janë zbutur dhe mund të jenë edhe kafshë shtëpiake. Njerëzit i njohin ato për mishin e tyre, vezët dhe puplat me të cilat mund të mbushen jorganë, dyshekë etj. Patat janë roje të mira në oborrin e fermës, sepse ata fillonë të bëjnë ga-ga-ga sapo vinë të panjohur.

Rendi i tingujve dhe shkronjave

Çdo gjë në natyrë ka rendin e vet, prandaj më parë qielli mbushet me re të zeza e pastaj fillon

të bjerë shiu. Dielli lind në mëngjes e hëna fillon e del kur perëndon dielli dhe pasi errësohet, dalin yjet. Edhe gjuha ka rregullat e saj, prandaj në çdo gjuhë tingujt e shkronjat kanë rendin e tyre. Për të krijuar fjalë, tingujt shkronjat duhet të vendosen sipas një renditjeje të caktuar.

III. LEXOJMË

Pema e jetës

Pema është simbol i jetës dhe i vazhdimësisë. Rrënjët e pemës janë të lidhura fort me të kaluarën, historinë tonë. Trungu përfaqëson forcën e cilësitë që na karakterizojnë. Ndërsa degët dhe gjethet janë simbol i shpresave, dëshirave dhe ëndërrave tona. Edhe tingujt e shkronjat janë themelet e një gjuhe dhe me anë të tyre mund të krijojmë fjalë e fjali e mund të tregojmë ngjarje e ndodhi.

Bimët

Bimët kanë një cikël jetësor, ashtu si njerëzit dhe kafshët e tjera. Cikli jetësor i bimës përshkruan fazat nëpër të cilat kalon bima nga fillimi i jetës së saj deri në fund. Cikli jetësor i një bime fillon me një farë. Brenda shtresë së farës është një embrion, i cili do të bëhet bimë e re. Farërat kanë nevojë për katër gjëra për t'u rritur: oksigjen, lagështi, rrezet e diellit dhe temperaturën e duhur. Kur të plotësohen kushtet e duhura për farën, ajo do të fillojë të mbijë. Pastaj rritet dhe krijon një fidan. Fidani rritet dhe bima fillon të lulëzojë. Dalëngadalë lulet krijojnë frytin. E kështu cikli përsëritet.

V. DËGJOJMË DHE KOMUNIKOJMË

Ruajmë natyrën

Shpesh dëgjojmë shprehjen "të jemi të gjelbër". Po cili është kuptimi i saj? Pse përmendet ngjyra e gjelbër? E gjelbra është më shumë se një ngjyrë, ajo nënkupton mbrojtjen e mjedisit ku jetojmë. Bimët janë të gjelbra dhe pa to toka nuk do të eskzistonte. Çfarë mund të bësh ti për të qenë i gjelbër?

Ja disa hapa:

- Zvogëlo sasinë e gjërave që përdor ose që i hedh në kosh.
- Ripërdori gjërat kur ke mundësi.
- Shijoje natyrën. Ec në pyll, mbill një pemë etj.

Pranvera

Pranvera është stina e parë e vitit. Me ardhjen e pranverës natyra gjallërohet, moti bëhet më i ngrohtë, dita është më e gjatë. Cilat janë shenjat e pranverës?

Gjatë dimrit, degët e pemëve janë të zhveshura, ndërsa tani ato kanë sytha të cilat do të bëhen gjethe ose lule. Pranvera ka ditë me diell, por edhe me shi. Shiu është i domosdoshëm për bimët që ato të rriten. Pranvera është koha më e mirë për të mbjellë në kopsht. Mbillni fara dhe ujitini ato çdo ditë. Shikoni kopshtin tuaj të rritet.

Kujdesi për dhëmbët

Në kohët e lashta njerëzit përdornin bimë të ndryshme për t'u kujdesur për dhëmbët. Sot kemi mjete dhe mjekë që e kanë profesion. Ata quhen dentistë. Dentistët na ndihmojnë që të mjekojmë dhëmbët dhe t'i parandalojmë sëmundjet që lidhen me to. Larja e dhëmbëve të paktën dy herë në ditë mund të parandalojë prishjen e dhëmbëve. Megjithatë vizitat

duhen bërë tek dentisti të paktën një herë në vit.

Telefoni

Njerëzit i ndajnë informacionet me njëri-tjetrin përmes komunikimit. Të gjitha format e komunikimit kanë një gjë të përbashkët: dërgimin dhe marrjen e një mesazhi.

Për të komunikuar mund të përdoren edhe mjete elektronike, si telefoni, televizori, radioja, kompjuteri etj. Në fillim telefoni e transmetonte mesazhin vetëm nëpërmjet telave, ndërsa sot kemi telefon celular që e realizojnë transmetimin në mënyrë elektronike.

Burime dhe literatura

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Gramatikë e gjuhës shqipe* (grup autorësh), Tiranë, 2002.
3. Beci, Bahri, *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Shkup, 2004.
4. Brooker, L. (2002). 'Five on the First of December!': What can We Learn from Case Studies of Early Childhood Literacy? *Journal of Early Childhood Literacy*, 2(3), 291-313. <https://doi.org/10.1177/14687984020023003>.
5. Bushati, Jozef & Dibra, Gëzim & Priku, Mimoza, "Problematic of learning for reading and writing in pre-school and first grade of pre-university education, through multimedia" [Problematika të të mësuarit të lexim -shkrimit në parashkollor dhe klasën e parë të arsimit parauniversitar, përmes multimedias], *Education for the knowledge society*, 1st Albania International Conference on Education (AICE), Tirana, 7-8 december, Proceeding pg. 102-114.
6. Clark EV. *First Language Acquisition*. Cambridge University Press, 2009.
7. Gjokutaj, M. & Dode, E., *Didaktika e gjuhës shqipe* (kurrikula I-VI), Shtëpia Botuese "Shkronjë pas Shkronje", Tiranë, 2013.
8. Gjokutaj, M., Rreth metodave të të mësuarit të lexim-shkrimit, *Mësuesi*, 1994.
9. Dowdall N, Melendez-Torres GJ, Murray L, Gardner F, Hartford L, Cooper PJ. Shared Picture Book Reading Interventions for Child Language Development: A Systematic Review and Meta-Analysis. *Child Dev.* 2020 Mar;91(2):e383-e399. doi: 10.1111/cdev.13225. Epub 2019 Feb 9. PMID: 30737957.
10. Flack ZM, Field AP, Horst JS. The effects of shared storybook reading on word learning: A meta-analysis. *Dev Psychol.* 2018 Jul; 54(7):1334-1346. doi: 10.1037/dev0000512. Epub 2018 Mar 29. PMID: 29595311.
11. Medlicott, Mary, *Storytelling and story-reading in early years: How to tell and read stories to young children*. Jessica Kingsley Publishers: London and Philadelphia, 2018.
12. Priku, M. & Bushati, J. & Sula, A. & Kashahu, L. "One approach for the role of rhyming dictionaries in developing children's language proficiency and the multimedia technologies" [Një qasje për rolin e fjalorëve rimorë në zhvillimin e aftësive gjuhësore të fëmijëve dhe teknologjive multimediale], në *European Scientific Journal*, May 2014 edition vol.10, f. 24- 35.
13. Programi i lëndës mësimore "Gjuhë shqipe dhe Letërsi" (Për klasat I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII dhe IX të shkollës fillore), Enti i Shkollimit në Mal të Zi, Podgoricë, 2017.

